


RAPORT I VLEËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR (impianti) me veprimtarin
mbledhjes, grumbullimit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe
magazinimit të mbetjeve të tullave zjarrrdurese (refraktare)
Në lokacionin zona industriale e Trepçës Mitrovicë



“MIRECO” SH.P.K.”

Aplikuesi:

“MIRECO” SH.P.K.

Mars 2025

Titulli i projektit: (impianti) qe synon te ushtroj me veprimtarin mbledhjes, grumbullimit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve te tullave zjarrduruese (refraktare)	
Aplikuesi i projektit	Emri i kompanisë: “MIRECO” SH.P.K. Argjend HALILI – drejtor Tel: +383 48 885 666 E-mail: argjend.halili@horn-co.de
Lokacioni	Zona Industriale: Objekti i Trepça Sh.A. Komuna: Mitrovicë Zona Kadastrale: Shupkovc Parcelat Kadastrale: P-71208128-01090-1 Koordinatat: 42°52'57.6"N 20°52'54.2"E Sipërfaqja e objektit dhe hapësirës për shfrytëzim: 5.400.00 m²
Hartues i raporti për VNM	Dr.Sc. Astrit Shala Nr. i licencës: 32/19/24 Email: astrit-shala@hotmail.com Tel: +383 44 800 098 Adresa: Prishtinë

Investitori: “MIRECO” SH.P.K.

Hartuesi: Dr.Sc. Astrit Shala

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

Përmbajtja

HYRJE	7
1. QËLLIMI I STUDIMIT	9
1.1. Përshkrimi i alternativave të arsyeshme.....	10
2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	12
3. METODOLOGJIA E PUNËS	14
3.1. Zona në studim.....	14
3.2. Metodologjia e hartimit të VNM-së.....	15
3.3. Mbledhja e të Dhënave	16
3.4. Analizat studimore	16
3.5. Ekosistemet Natyrore	17
3.6. Sistemi i Mbrojtjes së Natyrës.....	17
4. PËRSHKRIMI I PËGJITHSHËM I MJEDISIT DHE LOKACIONIT	18
4.1. Pozita gjeografike	18
4.2. Kushtet Gjeoteknike.....	21
4.2.1. Gjeologjia	21
4.2.2. Karakteristikat geomorfologjike.....	25
4.2.3. Karakteristikat topografike	26
4.3. Karakteristikat klimatike.....	28
4.3.1. Temperatura e ajrit.....	29
4.3.2. Reshjet.....	30
4.3.3. Hidrografia.....	31
4.3.4. Flora.....	33
4.3.5. Zoodiversitetit.....	33
4.4. Aspektet kryesore të gjendjes aktuale mjedisore.....	35
4.4.1. Popullsia	35
4.4.2. Shëndeti	37
4.4.3. Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin.....	37
4.4.4. Veçori natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen	38
4.4.5. Zonimi i territorit të komunës	38
4.4.6. Zonat e mbrojtura.....	38
4.4.7. Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale	39
4.4.8. Pyllëzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e blerta dhe të pushimit.....	39
4.4.9. Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik.....	39
5. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	41
5.1. Rruga për qasje në lokacion	42
5.2. Rrethoja e lokacionit	42

5.3.	Masat gjatë fazës së para funksionimit-operimit	42
6.	PËRSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK.....	43
6.1.	Tulla zjarrrduruese	43
6.2.	Reduktimi, Ripërdorimi, Riciklimi (3R).....	43
6.3.	Punimet sipërfaqësore rreth lokacionit.....	44
6.4.	Përmbajtjet dhe pajisjet funksionale dhe teknologjike sipërfaqësore.....	44
6.4.1.	Procesi i grumbullimit	47
6.4.2.	Procesi i ndarjes-sortimit.....	48
6.4.3.	Procesi i bluarjes-thërrmimi	49
6.4.4.	Mbushja e thasëve.....	50
6.4.5.	Kompleksi i kontejnerëve në lokacion.....	51
6.5.	Furnizimi me ujë	51
6.6.	Furnizimi me energji elektrike.....	52
6.6.1.	Trupat ndriçues	53
6.6.2.	Masat për kursimin e energjisë.....	54
6.7.	Qasja në sistemet e kanalizimit.....	54
7.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS	55
8.	PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS	57
8.1.	Efektet vizuale (peizazhi).....	57
8.2.	Vlerësimi i ndikimit në mjedis	58
8.2.1.	Ndotja e ajrit.....	58
8.2.2.	Ndotja e ujit	58
8.2.3.	Ndotja e tokës	60
8.2.4.	Zhurma.....	61
8.2.5.	Ndikimet në florë dhe faune	62
8.2.6.	Ndikimet në ekologjinë lokale.....	62
8.2.7.	Ndikimet në komunitetin dhe ekonominë lokale.....	63
8.2.8.	Ndikimet në trashëgiminë kulturore.....	64
8.2.9.	Ndikimet nga trafiku	64
8.3.	Rreziku i shëndetit dhe sigurisë në punë.....	64
9.	MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE.....	65
9.1.	Masat e marra dhe mobilizimi / Para-ndërtimi	65
9.2.	Masat e marra gjatë fazës së përgatitore dhe instalimit.....	66
9.3.	Masat për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis	67
9.3.1.	Identifikimi dhe përcaktimi i masave zbutëse dhe menaxhuese	67
9.3.2.	Masat e mbrojtjes së ajërti	68
9.3.3.	Masat për mbrojtjen tokës.....	68

9.3.4.	Masat e mbrojtjes së ujit	69
9.3.5.	Masat e marruara në Florë	69
9.3.6.	Masat e marruara në Faunë	70
9.3.7.	Mbrojtja nga zjarri	70
10.	MUNDËSIA E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR.....	72
10.1.	Punimet Inxhinierike	72
10.2.	Punimet biologjike	72
11.	MENAXHIMI DHE MONITORIMI I MJEDISIT	73
11.1.	Kontraktori	73
11.2.	Inxhinieri i Mjedisit.....	73
11.3.	Qeveria e Kosovës / Ministria përkatëse / Klienti	74
11.4.	Autoritetet përkatëse të mjedisit	74
11.5.	Monitorimi i mjedisit	75
12.	MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT	76
12.1.	Objektivat e rikultivimit	76
13.	PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET	78
	Referencat	80

Lista e hartave:

Harta 1: Pozita gjeografike e Mitrovicës në Kosovë.....	18
Harta 2: Pozita gjeografike e lokacionit në komunën e Mitrovicës	19
Harta 3: Harta gjeologjike e Mitrovicës	22
Harta 4: Morfologjia e terrenit	26
Harta 5: Topografia e terrenit.....	27
Harta 6: Rajonet klimatike të Kosovës.....	28
Harta 7: Rrjeti hidrografik i zonës	32

Lista e figurave:

Figura 1: Planimetria e përgjithshme e Impiantit për Deponimin e Materialeve Zjarrruduese të përdorura dhe bluarja e tyre.....	14
Figura 2: Lokacioni i impiantit në raport me rrugët.....	20
Figura 3. Situacioni i terrenit me koordinatat e hapësirës qe është marre me qira për shfrytëzim.	21
Figura 4: Projekti konceptual	45
Figura 5: Projekti ideor, urbanistik dhe konceptual	46
Figura 6: Objekti ku do të zhvillon funksioni impianti, hapësira ku grumbullohet materiali	47
Figura 7: Makina e sortimit.....	48
Figura 8: Makineria për bluarje-thërmim.....	49
Figura 9: Koncepti si funksionon procesi përpunues i gurthyesit	50
Figura 10: Mbushja e thasëve Big Bags	51

Lista e tabelave:

Tabela 1: Temperaturat mesatare mujore Mitrovicë, Prishtinë dhe Rrafshi i Kosovës.....	29
Tabela 2: Sasia mesatare e reshjeve (mm)	30
Tabela 3: Numri i popullsisë sipas vendbanimeve.....	36
Tabela 4: Ndërveprimet mjedisore të identifikuara	55

Lista e grafikëve:

Grafiku 1: Shpërndarja vjetore e temperaturave të ajrit	30
Grafiku 2: Shpërndarja vjetore e temperaturave të ajrit	31

HYRJE

Sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (2030), Kosova synon që deri në vitin 2030 të krijojë dhe mbajë një mjedis të pastër, që në thelb ka parandalimin e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit, si dhe mbrojtjen e biodiversitetit në përgjithësi, të gjitha këto në funksion të një jetese më cilësore. Gjithashtu, të vetëdijshëm që vendi ka potencial të burimeve natyrore, do të ketë shfrytëzim më efektiv dhe më të qëndrueshëm të këtij potenciali. Nëpërmjet realizimit të këtij qëllimi zhvillimor, Kosova i bashkohet bashkësisë ndërkombëtar për adresimin e sfidave globale të mjedisit.¹

Në kuadër të procesit për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për “Impiantin që synon të ushtroj veprimtarin për; Grumbullit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve të tullave zjarrruduese (refraktare)”, është bërë përmbledhja dhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për hartimin e **Raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis**.

Përmes këtij raport janë marrë për bazë karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin e këtij projekti, si dhe karakteristikat e potencialeve natyrore përkatëse, e në bazë të tyre është bërë identifikimi, si dhe janë analizuar ndikimet e mundshme mjedisore, të cilat mund të rrjedhin gjatë punimit dhe finalizimit të projektit nga veprimtaritë inxhinierike e teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit.

Përmes këtij raportit do të prezantohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten si gjatë punimit – ndërtimit, ashtu edhe gjatë operimit të impiantit në relacionin e objektit me mjedisit, andaj ky raport përgatitet me qëllim të identifikimit të ndikimeve potenciale në mjedis, si dhe zbatimin e preventivave të cilat do të jenë të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.

Edhe pse aktivitetet e impiantit nuk priten të gjenerojnë efekte të mëdha dhe të pa kthyeshme negative në mjedis, megjithatë ato në vetvete mund të bartin efekte mjedisore të cilat duhet të merren në konsiderate.

Raporti përshkruan:

- Gjendjen e përgjithshme në dhe rreth lokacionit;
- Kushtet mjedisore ekzistuese;
- Përshkrimi teknik i projektit dhe punimet të cilat do të kryhen;
- Ndikimet e mundshme të projektit në mjedis;

¹ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030, Prishtinë, 2023, faqe 30.

- Identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve dhe ndërmarja e masave adekuate për evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij biznesi në mjedis janë komponentët kryesore të këtij raporti.

Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me investitorin, prej të cilit janë marrë të dhënat kryesore dhe të nevojshme përmes takimeve dhe bisedave.

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna nga përshkrimi teknik i projektit si dhe të dhëna dhe materiale për projekte të ngjashme, janë realizuar vizita në lokacionin e projektit dhe janë bërë fotografi për hartimin e këtij raporti. Territori apo zona në studim nuk është i përfshirë në ndonjë zonë të mbrojtur, monument natyrore, park natyral, rezervat apo park kombëtar.

1. QËLLIMI I STUDIMIT

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis (VNM) si dhe për të identifikuar masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për **“Impiantin qe synon te ushtroj veprimtarin për; me veprimtarin për; mbledhjes, grumbullimit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve te tullave zjarrrduese (refraktare)**, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme sipas fazave.

Duhet të bëhen shumë kompromise për të arritur ekuilibrin optimal midis ndërtimit, funksionimit dhe mjedisit. Ky raport thekson disa nga elementet dhe parametrat teknikë që merren parasysh gjatë projektimit, ndërtimit dhe funksionimit të **“Impiantin qe synon te ushtroj veprimtarin për; me veprimtarin për; mbledhjes, grumbullimit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve te tullave zjarrrduese (refraktare)**, Kombinimi i tyre dhe llogaritjet teknike bëjnë të mundur optimizmin e sistemit dhe performancën e tij maksimale.

Pavarësisht hapjes së tregjeve dhe integritetit rajonal që pritet të sigurojnë efekte lehtësuese në drejtim të problemit të furnizimit, është e nevojshme të merren masa sa më shpejt të jetë e mundur për të zhvilluar kapacitetet e duhura gjeneruese, duke marrë parasysh detyrimet ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, ndryshimin klimaterik, dhe përmbushjen e kriterëve minimale.

Rëndësia dhe objektivi i këtij biznesi është në atë se zhvillimi i kapaciteteve të tilla ka ndikime të shumta në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor të zonës dhe vendit në përgjithësi.

Ndryshimi i infrastrukturës në procesin e vlerësimit të përdorimit hapësinor shihet më së miri në elementet vijuese:

- Mundësia për ripërdorimin e burimeve natyrore;
- Ndikimi në zhvillimin e kapaciteteve të biznesit dhe banimit;
- Ndikimi në zhvillimet urbane, zhvillimin e vendbanimeve dhe cilësinë e mjedisit;
- Ndikon dhe nxit zhvillimin e zonës së biznesit duke stabilizuar tregu për nevojat e konsumatorëve;
- Ndikimi i drejtpërdrejtë në ndalimin e migrimit të banorëve nga zona.

Objektivi i projektit - është avancimi infrastrukturor që synon të përmirësojë kushtet e jetesës së komunitetit, i cili do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në punësimin, arsimin, kujdesin shëndetësor, bujqësinë dhe aspektet e përgjithshme të jetës socio-ekonomike.

Qëllimi objektiv i këtij zhvillimi

- Të vlerësojë dhe rekomandojë rregullimin e mjedisit, së pari në lidhje me elementët parësore, siç janë ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmës, uji dhe cilësia e ajrit.

Për të shpëtuar ose rehabilituar mjedisin natyror nevojiten ndërhyrje të reja pozitive në projektin e zbatimit ose punime të veçanta brenda projektit ose paralelisht me të, të cilat sigurojnë një vazhdim të qëndrueshëm të mjedisit biologjik, duke përfshirë florën dhe faunën përreth zonës.

Pos tjerash nevojiten edhe informata shtesë siç janë:

➤ Informatat themelore mbi:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis;
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion;
- Karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit;
- Klima dhe të dhënat meteorologjike;
- Kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion;
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit.

➤ Vlerësimi i ndikimeve sipas kritereve në vijim:

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit;
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti;
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës;
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes.

➤ Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet / të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

1.1. Përshkrimi i alternativave të arsyeshme

Duke u bazuar në faktorë të ndryshëm si;

- Pozita e mirë gjeografike;
- Përshtatshmëria e terrenit (ekspozicioni, pjerrësia, kategoria e tokës);
- Mundësia për riprodhimin dhe ripërdorimin e produkteve të materialeve zjarrruduese të përdorura;
- Se kjo hapësirë është zonë industriale dhe jo bujqësore dhe rrjedhimisht është një potencial mjaftë i mirë për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive të tilla;

- Distanca me objektet e banimit e mjaftueshme etj.

Duke u bazuar në faktorët e lartë cekur, kuptojmë se lokacioni në fjalë është mjaftë i favorshëm për projektet e kësaj natyre dhe rrjedhimisht këto zona janë zgjedhur për operimin dhe funksionalizimin e fabrikave të kësaj natyre. Kjo alternative është përzgjedhur për arsye se është zonë shumë e përshtatshme për zhvillimin e projekteve të tilla dhe nuk do të ketë efekte në lokalitetin ku zhvillohet. Lokacioni ka qasje të mirë në rrugë, si dhe ka qasje të mirë për tu kyçur në transmisioni.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-SË

Para se të fillohet me studimin e një zonë apo operimin e një biznesi i cili i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, është me rëndësi të shqyrtohen ligjet për mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar në karakteristikat e impiantit me infrastrukturë përcjellëse dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt që është planifikuar të ndërtohet është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore te cilit ju kemi referuar.

Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së janë si me poshtë:

- LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)
- LIGJI I PLANIFIKIMIT NR. 04 / L-174
- LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NR. 03/L-025
- LIGJI NR. 03/L-230 PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VSNM)
- LIGJI NR. 08/L-025 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA
- LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS NR. 04/L-147
- LIGJI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NR. 04/L-174
- LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA
- LIGJI NR. 08/L-116 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-197 PËR KIMIKATE
- LIGJI NR. 03/L-233 PËR MBROJTJEN E NATYRES
- LIGJI NR. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA
- LIGJI NR. 04/L – 110 PËR NDËRTIM
- LIGJI NR. 04/L-175 PËR INSPEKTORATIN E MJEDISIT, UJËRAVE, NATYRËS, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE NDËRTIMIT
- LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË
- LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA
- LIGJI NR. 04/L-012 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI
- LIGJI NR. 08/L-112 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-26 PËR TOKËN BUJQËSORE
- LIGJI NR. 2003/3 PËR PYJET E KOSOVËS, NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 03/L-153
- LIGJI NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE
- LIGJI NR.05/L-081 PËR ENERGIJË
- LIGJI NR.05/L-085 PËR ENERGIJË ELEKTRIKE
- LIGJI NR.05/L-084 PËR RREGULLATORIN E ENERGIJË
- UDHËZIM ADMINISTRATIV (MZHE) NR. 03/2017 MBI RREGULLAT PËR ZONAT E SIGURISË
- RREGULLA – ZRRE/NR.03/2022 PROCEDURA E AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E PROJEKTEVE TË ENERGIJË.
- UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPH) NR. 04/2017 PËR KATEGORIZIMIN E NDËRTIMEVE
- UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 02/2022 PËR KUSHTET, MËNYRAT, PARAMETRAT DHE VLERAT KUFIZUESE TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA NË RRJETIN E KANALIZIMIT PUBLIK DHE NË TRUPIN UJOR
- UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 07/2021 PËR RREGULLAT DHE NORMAT E SHKARKIMEVE NË AJËR NGA BURIMET E PALËVIZSHME TË NDOTJES
- UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPH) NR.16/2015 PËR INFORMIM, PJESËMARRJE TË PUBLIKUT DHE PALËVE TË INTERESUARA NË PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

- *UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) – NR. 03/2021 PËR MENAXHIMIN MBETURINAVE TËRREZIKSHME*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) – NR. 08/2017 PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË MBETURINAVE*
- *UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.13/2013 PËR KATALOGUN SHETËROR TË MBETURINAVE*
- *UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH, NR.10/2015 PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE NGA PRODUKTET MEDICINALE.*
- *UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 07/2012 PËR CILËSINË E KARBURANTEVE TË LËNGËTA TË NAFTËS*
- *UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.05/13. PËR MENAXHIMIN E VAJRAVE TË PËRDORURA DHE MBETURINE.*

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura (MMPHI).

Përveç dispozitave themelore ligjore rregullatorë të përmendura më lart në lidhje me nevojën për të përgatitur raportin e VNM-së u përdorën edhe rregullore të tjera ligjore, përfshirë ligjet të cilat janë në fuqi. Për shkak se një pjesë e madhe e specifikimeve mjedisore nuk përfshihet në kornizën ligjore të lartpërmendur për të hartuar këtë raport u përdorën rregullore dhe udhëzime ndërkombëtare të përshtatshme në lidhje me mjedisin siç janë Direktiva e VNM (85/337 / EEC).

3. METODOLOGJIA E PUNËS

3.1. Zona në studim

Përcaktimi i zonës së studimit është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme sepse përcakton fushën e procesit të VNM-së. Figura 1 tregon paraqitjen e përgjithshme të **“Impiantin qe synon te ushtroj veprimtarin për; Grumbullit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve te tullave zjarrduruese (refraktare)”**, duke përfshirë edhe afërsinë e lokacionit.




Figura 1: Planimetria e përgjithshme e Impiantit për Deponimin e Materialeve Zjarrduruese të përdorura dhe bluarja e tyre.

Ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale u studiuan në një zonë prej 9-12 km nga qendra e impiantit. Brenda këtij sektori të cilat kanë të bëjnë me natyrën dhe nivelin e mundshëm të ndikimit janë identifikuar dy zona.

Ndikimet e identifikuara brenda secilës zonë kanë karakteristika dhe shtrirje të ndryshme - në përgjithësi, ato përfshijnë ndikime të drejtpërdrejta negative si dëmtim fizik i shkaktuar tokës, burimeve natyrore dhe ndërtimeve ekzistuese, zhurmës, ndotjes së ajrit, etj. Nga ana tjetër, ndikimet në zonat e gjera të studimit kanë karakter më funksional, gjë që lidhet me ndërprerjen e efektit vizual, ndarjen hapësinore të bashkësive, etj.

3.2. Metodologjia e hartimit të VNM-së

Metodologjia e zgjedhur është rezultat i nevojës për të ekuilibruar aspekte të ndryshme të projektit. Qasja aktuale metodologjike bazohet kryesisht në përdorimin e të dhënave në dispozicion, mostrave, vizitave në terren dhe ekspertizës së specialistëve të nivelit të lartë.

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis (VNM) si dhe për të identifikuar masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për zonën e projektit për **“Impiantin qe synon te ushtroj veprimtarin për; Grumbullit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve te tullave zjarrduruese (refraktare)”**, i cili ndodhet në qytetin e Mitrovicës, saktësisht në lokacionin industrial të ndërmarrjes Trepça në Mitrovicës, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyrë, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme sipas fazave.

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis, kalon në disa faza edhe atë:

➤ **Informatat themelore që nënkupton identifikimet siç janë:**

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis;
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike;
- klima dhe të dhënat meteorologjike;
- karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit;
- kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion;
- bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit.

➤ **Vlerësimi i ndikimeve sipas kritereve në vijim:**

- gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit;
- lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti;
- karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës;
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar;
- vlerësimi i përhapjes së ndotjes.

Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, do të bëhet duke u bazuar në rezultatet/ të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

➤ **Analiza e rrezikimit të:**

- Njeriut;
- vlerave materiale;
- vlerave natyrore.

- Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedisin e lokacionit.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimin të gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3.3. Mbledhja e të Dhënave

Vlerësimi i ndikimit në mjedis u përgatit bazuar në disa burime informacioni:

- të dhëna të disponueshme për kushtet mjedisore në Kosovë;
- studime mjedisore të realizuara për projekte të ngjashme;
- specifikimet teknike të projektit, të siguruar nga konsulentët kryesorë të projektit;
- informacioni i mbledhur gjatë vizitave në terren;
- informacioni i mbledhur gjatë konsultimeve me administratën dhe institucionet kombëtare dhe lokale, komunat dhe përfaqësuesit e grupeve të ndryshme socio-profesionale;
- dokumente të tjera specifike teknike të përdorura për vlerësimet mjedisore dhe gjeoteknike renditen në kapitujt përkatës.

3.4. Analizat studimore

Bazuar në analizën e studimit (fushëveprimi), aspektet sociale dhe mjedisore të renditura më poshtë janë identifikuar si potencialisht të ndjeshme në lidhje me zhvillimin e projektit:

- një përzierje e aktiviteteve të ndryshme përfshirë bujqësinë, infrastrukturën dhe funksionin e banimit, tipike për zonat periferike;
- përdorimi bujqësor i tokës dhe cilësia e mirë e saj;
- prania e bio-korridoreve dytësore së bashku me zonat kryesore të ujit, kryesisht përgjatë lumit Sitnica, dhe lumit Ibër, si dhe disa burime ujore më të vogla.
- jo burime uji nëntokësore, të përdorura për ujë të pijshëm dhe qëllime ujtjeje.

Duke synuar të kemi një hulumtim që do të rezultojë në një Vlerësim të Qëndrueshëm të Ndikimit në Mjedis, janë identifikuar pikat e mëposhtme:

- Identifikimi i kategorive për përdorimin e tokës;
- Identifikimi i ndikimeve dhe konflikteve socio-mjedisore;
- Ndikimi i zhurmës;
- Ndikimi në ajër;
- Ndikimi në florën dhe faunën;
- Ndikimi në shëndetin e njeriut;
- Plani i Monitorimit dhe Menaxhimit të Mjedisit;
- Informacioni publik.

3.5. Ekosistemet Natyrore

Edhe pse është një vend i vogël, ekosistemet natyrore dhe biodiversiteti në Kosovë janë mbresëlënëse. Pozicioni i tij gjeografik, së bashku me faktorët gjeologjikë, pedologjikë dhe hidrologjikë, peizazhin dhe klimën kanë krijuar lloje të ndryshme të habitateve dhe peizazheve, me florë dhe faunë të larmishme, duke përfshirë shumë specie relikte ose endemike. Për shkak të faktorëve ekonomikë dhe historikë, ekosistemet natyrore të fushave janë transformuar ndikuar nga aktivitetet njerëzore dhe kanë humbur shumicën e vlerave të tyre ekologjike. Zona të paprekura dhe të pashkelura ekzistojnë vetëm në zonat malore.

3.6. Sistemi i Mbrojtjes së Natyrës


Sistemi i zonave të mbrojtura natyrore në Kosovë u krijua në vitin 2006 përmes ligjit për ruajtjen e natyrës (Rregullorja 2006/22). Sipas rregullores, zonat e mbrojtura janë "zonat e ruajtjes së natyrës të përcaktuara për të mbrojtur dhe mirëmbajtur biodiversitetin, peizazhet, tiparet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe për të siguruar menaxhim efektiv përmes mjeteve ligjore dhe të tjera.

Në afërsi të lokacionit, nuk ndodhet ndonjë parku kombëtarë, zonë e mbrojtur, si dhe nuk ndërhyr në asnjë zonë arkeologjike apo të varianteve tjera kulturore. Ndërtimi i projektit të propozuar nuk përbënë asnjë kërcënim për ndonjë material kulturor në këtë zonë.

4. PËRSHKRIMI I PËGJITHSHËM I MJEDISIT DHE LOKACIONIT

4.1. Pozita gjeografike


Sipërfaqja e tërësishme e Komunës së Mitrovicës, e cila gjendet në pjesën veriore të Kosovës, është 326 km². Largësia nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina është 42 km. Territori i Komunës shtrihet në 42.53 shkallë të gjerësisë gjeografike veriore dhe në atë 25.52 shkallë të gjerësisë lindore me lartësia mbidetare është 508- 510 m.



Harta 1: Pozita gjeografike e Mitrovicës në Kosovë

Lokacioni i projektit për “*Impianti për Deponimin e Materialeve Zjarrduruese të përdorura dhe bluarja e tyre*”, në Mitrovicë, ndodhet në veri të Kosovës (42° 52' 58" gjerësisë gjeografike veriore dhe 20° 52' 55" gjatësi gjeografike lindore), si dhe ndodhet në pjesën qendrore të komunës së Mitrovicës përkatësisht brenda hapësirës industriale të kompleksit Trepça-shoqëri aksionare, Mitrovicë, me sipërfaqe prej rreth 54 ari (5400m²), afërsisht 1.7 km vij ajrore larg nga

qendra e Mitrovicë, ndërsa nga komuna e Vushtrisë ka një largësi prej 13 km dhe 42 km nga Qyteti i Prishtinës. Në figurën me poshtë tregohet vendndodhja e deponisë.



Harta 2: Pozita gjeografike e lokacionit në komunën e Mitrovicës

Zona e projektit (shih figurën më lartë) ndodhet në lindje të qytetit të Mitrovicë t, në afërsi të fshatit Shupkoc në zonën industriale të Trepçës. Terreni në hapësirën ku do të vendoset kjo veprimtari, kryesisht është ultësorë, me rreth 510m lartësi mbidetare, kurse në lindje ngritët Mali i Kopaonikut, i cili shtrihet edhe mbi 1500m lartësi mbi nivelin e detit. Ky mal në territorin e komunës së Mitrovicës ndahet në dy pjesë nga Lumi Trepça. Më përëndim të lokacionit, në një distancë prej rreth 1 km shtrihet qyteti i Mitrovicës, në kuadër të pjesës më veriore të Rrafshit të Kosovës. E gjithë zona e lokacionit është ulët, kryesisht zonë industria që nga e kaluara, ndërsa zona malore në lindje kryesisht pyjore e pasur me minerale të shumta.

Lokacioni i veprimtarisë në fjalë mund të arrihet përmes rrugës magjistrale Prishtinë-Mitrovicë. Objekti me magjistralen do të lidhet përmes rrugës “Albaniku”, me një distancë prej rreth 500m.



Figura 2: Lokacioni i impiantit në raport me rrugët




Figura 3. Situacioni i terrenit me koordinatat e hapësirës që është marre me qira për shfrytëzim.

4.2. Kushtet Gjeoteknike

Investigimi gjeoteknik i vendit është kryer në zonën e projektit. Qëllimi i studimit është të sigurojë informacion mbi litologjinë, gjeomorfologjinë, hidro-gjeologjinë dhe karakteristikat gjeoteknike për vendin e ndërtimit të impiantit. Studimi gjeoteknik për këtë fazë bazohet kryesisht në hartën gjeologjike dhe përvojën e Konsulentit.

4.2.1. Gjeologjia

Në pikëpamje gjeologjike dhe morfologjike territori i rrethinës së Mitrovicës bën pjesë në sistemin dinarik. Në aspektin tektonik, rajoni i Mitrovicës futet në kuadër të Zonë së Jashtme të Vardarit.

Rrethina e gjerë e lokacionit ku është planifikuar të operoj *Impianti për Deponimin Materialeve Zjarrduruese të përdorura* është e ndërtuar nga këto formacione gjeologjike:

- **Formacionet paleozoike**
- **Formacionet Mesozoikut**
- **Formacionet triasike**

- **Formacionet Jurasike**
- **Formacione kretake**
- **Formacione kenezoikut**
- **Depozitimet e Neogjenit**
- **Depozitimet e Kuaternarit**
- **Shkëmbinjtë sedimentarë të Pliocenit të poshtëm-Sipërm etj.**



Harta 3: Harta gjeologjike e Mitrovicës

Karakteristikë e Njësisë së Përbërë të Vardarit është prania e madhe e ofioliteve, si dhe ndërtimi i ndërlikuar i saj, si rezultat i përfshirjes së formacioneve në pyka të akrecionit oqeanik, gjatë mbylljes së basenit oqeanik të Vardarit. Mbulesa e Jurasikut të Sipërm dhe veçanërisht ajo

kretake, është mjaft e përhapur. Molasat oligo - miocenike, shoqëruar me një magmatizëm intruziv dacito - andezitik dhe riolitik, përbejnë një tjetër tipar dallues të Njesisë së Përbërë të Vardarit. Molasat pliocenike dhe mbulesat e Holocen - Pleistocenit zënë sipërfaqe të konsiderueshme.

Formacionet paleozoike të NJV përhapen si në pjesën veriore. Marredhëniet e tyre me formacionet ofiolitike dhe melanzhin tektono - olistostromik janë tektonike. Në daljen veriore nga Rogozna, deri në Jugperëndim të Leposavigit, përfaqësohen nga filite, shiste sericitike, sericit - kloritike, gneise, shiste biotitike dhe feldshpatike mikore, ranorë të metamorfizuar, (kuarcorë dhe feldshpatikë), kuarcite, metadiabaze, ndërshtresa mermerësh etj. Në rrethinat e vendburimit të Stantërgut, Smrekonicës dhe në Kershin e Madh, Paleozoiku përfaqësohet nga shiste të gjelbra, argjilo - filite, argjilorë e silicorë, mermerë dhe kuarcite. Mbi to shtrihen konglomerate të P-?T, dhe shkëmbinj të tjerë triasikë. Kohët e fundit, pa të dhëna faunistike, mosha e formacioneve paleozoike të Trepçës është trajtuar si e Paleozoikut të Sipërm. Paraqesin metamorfizëm të gradës së ulët. Fakti që në Çiçavicë janë takuar edhe formacione të Triasikut të Mesëm, tregon se ato janë metamorfizuar së bashku gjatë Jurasikut të Mesëm.

Në stratigrafinë e Mesozoikut (Mz) vërehen konglomerato ranorët e Permo - Triasikut të Poshtëm takohen në dalje të kufizuar vetëm në rajonin e Trepçës. Paraqesin shkallë të ulët metamorfizimi. Në rrjedhjen e sipërme të përroit të Trepçanës, në fshatrat Vllahi dhe Mazhiq, vërehet shtrirja trangresive, pajtuese e konglomeratëve mbi gëlqerorët e Stantërgut dhe metamorfitet tjerë të Paleozoikut

Formacionet triasike kanë përhapje në pjesën veriore të Njesisë së Jashtme të Vardarit. Në pjesën veriore, formacionet triasike zënë një sipërfaqe rreth 35 km², me shtrirje rreth Trepçës dhe Smrekonicës. Në rrjedhjen e sipërme të përroit të Trepçanës, pranë fshatrave Vllahi dhe Mazhiq, mbi gëlqerorët Stantërgut dhe metamorfiteve të tjera të Paleozoikut, shtrihen me pajtueshmëri strukturore formacione bazale konglomerato - ranorike të Permo - Triasikut të Poshtëm. Mbi to vijnë formacione të Triasikut të Poshtëm, të përfaqësuara nga shiste të zeza, (filite, argjilo - filite, shiste sericitike dhe grafitike) me ndërshtresa gëlqerorësh kristalin.

Formacionet e Triasikut të Mesëm kanë përhapje më të gjerë në rrethinat e Trepçës dhe Mitrovicës. Përfaqësohen nga filite, argjilo - filite, shiste grafitike, sericit kloritike dhe glaukofane, metaranorë, gëlqerorë kristalorë dhe metasilicorë me të cilët shoqërohen metadiabaze, metaspilite dhe metadiabaz - porfire. Rrallë takohen edhe trupa gabrosh të shndërruar në gabro amfibolite. Në gëlqerorët kristalin janë përcaktuar konodonte të Triasikut të Mesëm.

Triasiku i Sipërm është përcaktuar në Gëlqerorët e Smrekonicës. Lumi i Smrekonicës i ka prerë mes për mes këta gëlqerorë pllakorë me silicorë. Në pjesën e poshtme ato vijnë normalisht nëpërmjet shisteve dhe gëlqerorëve mergelorë në formacionet shistoze të Triasikut të

Mesëm. Trashësia e gëlqerorëve të Smrekonicës është rreth 150 m. Në pjesën poshtme, të mesme të gëlqerorëve pllakorë me silicorë, janë përcaktuar konodonte të Triasikut të Sipërm.

Formacionet Jurasike përhapen, kryesisht në gjysmën veriore të Njesisë së Jashtme të Vardarit. Ato takohen në jugperëndim të Leposaviqit, ndërmjet Trepçës dhe Besianës (Podujevës), e deri në disa kilometra në Veri të rrethinës së Prishtinës. Përfaqësohen kryesisht nga melanzhi tektono - olistostromik dhe pyka akrecionare oqeanike.

Në jugperëndim të Leposaviqit duket sikur melanzhi vendoset mbi metamorfitet paleozoike- triasike dhe mbulohet tektonikisht nga masat ofiolitike Melanzhi tektono - olistostromik dhe formacionet e prizmeve të akrecionit oqeanik, ashtu si edhe ofiolitet etj., mbulohen nga gëlqerorë.

Gëlqerorët e kuq nyjorë, në lindje të Leposaviqit, me shtrirje mbi melanzhin tektono - olistostromik, i përkasin formacionit të Jurasiko - Kretakut të Poshtëm. Në këta gëlqerorë, me trashësi 1.5 - 2 m, kompaktë, me ndërshtresa e thjerrëza silicore, janë përcaktuar amonite. Më sipër takohen gëlqerorë pllakëhollë, mergelore të facies pelagjike. Formime të Jurasiko Kretakut të Poshtëm takohen edhe në rrethinën e Trepçës: në Tërstenë, Bare, Vidishiç, Dedi etj., ku takohen kalpionella etj.

Formacione kretake përhapen edhe në pjesën veriperëndimore, përgjatë luginës së lumit Ibër, nga Juglindja e Leposaviqit, deri në Veriperëndim të Leshakut. Formacionet kretake, në këtë brez përfaqësohen vetëm nga ato të facies terrigjene të Kretakut të Sipërm dhe kryesisht të Senonianit.

Kenezoiku-Paleogjeni-Oligoceni (gy): Depozitimet oligocenike përhapen në pjesën veriore (plansheti Mitrovicë, Besianë), atë lindore e juglindore të Kosovës. Vendosen transgresivisht mbi formacionet më të vjetra. Përfaqësohen nga depozitime sedimentare detare (Oligoceni i Poshtëm), vullkano sedimentare (Oligocen i Poshtëm - Rupelian) dhe sedimentare e vullkano - sedimentare ligenore (Oligocen i Sipërm). Njësitë e Oligocenit të Poshtëm janë facie e ceket detare, tipike me gëlqerorë koralorë.

Neogjen-Mioceni i Poshtëm: Depozitimet e Miocenit të Poshtëm janë të përhapura në afërsi të Mitrovicës, në jugperëndim të ultësirës së Kopaonikut, në afërsi të fshatrave Skromë, Shlivovicë, Sllatinë. Në pellgun e Fushës së Kosovës, këto depozitime takohen gjerësisht në afërsi të minierës së Trepçës dhe në Rogoznë. Përfaqësohen, kryesisht nga seria vullkano -sedimentare.

Horizonti vullkanik shtrihet mbi horizontin bazal, ose edhe mbi formacionet më të vjetra gjeologjike të Kretakut, Jurasikut të Poshtëm, ultrabazikët, shkëmbinjtë triasik dhe paleozoik. Ato përfaqësohen nga brekçe vullkanike me copa dhe fragmente të andeziteve, amfibol biotiteve

daciteve, daciteve xhamore, ralle andeziteve piroksenike. Në këto veprimtari vullkanike janë formuar vendburimet e mëdha polimetalore të Pb Zn të rajonit të Trepçës.

Depozitimet e Pleistoceni përfaqësohet nga sedimente bazale zhavorrore – ranore. Shfaqen afër Vushtrrisë dhe Mitrovicës. Ato shtrihen mbi depozitimet liqenore të Miocenit e Pliocenit dhe më rrallë të flishit. Poshtë, përfaqësohen nga suargjila të kuqërremta, kafe të errëta zhavorrore, surëra me zhavorr, suargjila në disa vende.

Depozitimet e Holocenit janë përfshirë: aluvionet, proluvionet, deluvionet, rëzimet, morenat, gurët akullnajorë. Aluvionet janë takuar në luginat e lumenjve Ibër dhe Sitnicë. Përbëhen nga zhavorre e rëra dhe rrallë nga ndërshtresa suargjilore.


4.2.2. Karakteristikat gjeomorfologjike

Relievi i territorit të komunës së Mitrovicës përbëhet nga disa tërësi, megjithatë, relievi malor formon fizionominë kryesore të kësaj hapësire gjeografike.

Kategorisë së relievit kodrinor dhe malor i takojnë pjesa më e madhe e sipërfaqes, sidomos treva e Shalës së Bajgorës (në lindje), prandaj komuna e Mitrovicës është trevë më tepër malore sesa fushore. Relievi karakterizohet nga një ndërtim mjaft dinamik, sepse lumenjtë malorë bashkë me përroje me energji të madhe kanë bërë erozionin duke formuar lugina relativisht të thella, të cilat ndajnë malet e Shalës së Bajgorës njërin prej tjetrit në forma të izoluara malore dhe kodrinore.

Kuptohet, pamjes së tyre morfologjike të tanishme i ka paraprirë predispozicioni i lëvizjeve tektonike që ndodhën në kohën e terciarit kur mbi shtresat gëlqerore janë formuar shtresa të trasha të shkëmbinjve vullkanikë, të cilët, si rezultat i proceseve postvullkanike janë bartëse të xehes së plumbit e të zinkut. Shala e Bajgorës është e vendosur në lindje të Mitrovicës. Është rajon malor i ulët (1600 m). Dallohet për ujërat e shumta e kullotat e pasura.

Hapësira ku është i vendosur qyteti i Mitrovicës përfaqëson skajim më verior të Rrafshit të Kosovës, në veri dhe lindje shtrihet mali Kopaonik, ndërsa në veriperëndim shrihet mali Rogozna.




Harta 4: Morfologjia e terrenit

4.2.3. Karakteristikat topografike

Zona e impiantit ndodhet në qytetin e Mitrovicës, në veri të Kosovës. Sipërfaqja totale e zonës ku do të operoj *Impianti për Deponimin e Materialeve Zjarrduruese të përdorura dhe bluarja e tyre*”, është afërsisht 54 ari. Kuotat e terrenit variojnë nga 500 m në 525 m mbi nivelin e detit, ndërsa malet në lindje shtrihen mes 600-800m, e në disa raste edhe mbi 1000m mbi nivelin e detit.

Terreni ku do të ndërtohet impianti është kryesisht i rrafshët me një pjerrësi mesatare afërsisht 2%.



Harta 5: Topografia e terrenit

4.3. Karakteristikat klimatike

Zona e projektit për “**Impiantin qe synon te ushtroj veprimtarin për; Grumbullit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve te tullave zjarrrdurese (refraktare)**”, në Mitrovicë, do të ndërtohet në një zone me klimë kontinentale, zona II-b Kosova Veriore, Nën-Rajoni (Mitrovicë-Vushtri-Skenderaj).



Rajonet_Klimatike_Kosovë

- Ia-Rajoni Perëndimor i Rrafshit të Dukagjinit; Ib-Rajoni Qendror i Rrafshit të Dukagjinit; Ic-Prizren
- IIa-Peje-Istog; IIb-Kosova Veriore; IIc-Fusha e LLapit; IId-Kosova-Drenica; IIf-Kosova Jugore; IIf-Gjilan
- IIla-Alpet Shqiptare; IIlb-Mali i Sharit; IIlc-Kapaonik; IIId-Kosova Lindore

Harta 6: Rajonet klimatike të Kosovës

Zona II-b K o s o v a V e r o r e , nën-rajoni (Mitrovicë-Vushtrri) ndodhet midis zonës Alpeve Shqiptare IIIa në perëndim, zonës perëndimore Ila Pejë-Istog të Rrafshit të Dukagjinit në jugperëndim, , nën-rajonit I Ib Kosovë-Drenicë, IIc-Kopaonik në veri dhe I Ic Fusha e Llapit. Përfshin rrjedhën e lumit Sitnica dhe lumit Ibër, si dhe rrjedha lumore më të vogla.

Karakteristikat klimatike të Mitrovicës janë të njëjta, pothuajse në tërë territorin e Rrafshit të Kosovës. Mitrovica ka klimë kontinentale në të cilën klimë ndikon shumë afërsia Bjeshkëve të Nemuna, Rogoznës dhe Kopaonikut, si dhe rrymat e tjera të ajrit, që në viset e ulëta karakterizohet më vera të nxehta dhe të thata dhe më dimra relativisht të ftohtë dhe më lagështi.

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 70,2 %, në të cilën rast rritja është dukshëm më e madhe prej verës kah dimri për 17,5 %, se sa zvogëlimi prej dimrit në drejtim të verës. Në këtë rajon vranësirat mesatare vjetore janë 58 %, gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 60,5 (16,6 %) në vit, ndërsa e ditëve të vrerta 119,3 ditë (32,6 %).

4.3.1. Temperatura e ajrit

Temperatura e ajrit është një nga elementët klimatikë që karakterizon klimën e një rajoni. Një nga parametrat kryesorë të temperaturës së ajrit janë vlerat mesatare. Shpërndarja brenda vjetore e temperaturave të ajrit për stacionet e Mitrovicë, Prishtinë, si dhe mesatarja e Rrafshit të Kosovës tregohet në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Temperaturat mesatare vjetore të ajrit variojnë 11°C Mitrovicë. Temperatura mesatare e janarit varion midis – 0.2°C në Mitrovicë dhe –1.4°C në Prishtinë, ndërsa temperatura mesatare e korrikut është rreth 20°C.


Zona klimatike e Rrafshit të Kosovës, përgjatë luginës së Ibrit është nënshtruar ndikimit të masave ajrore kontinentale. Për këtë arsye, në këtë zonë mbizotëron dimri i ftohtë, me temperaturë mesatare rreth -1°C, rrallë deri në -26°C. Vera është e nxehtë dhe me temperaturë mesatare 20 - 21°C, rrallë deri në 37°C. Kjo zonë karakterizohet me klimë të thatë dhe me reshje mesatare vjetore prej 600 mm në vit.

Tabela 1: Temperaturat mesatare mujore Mitrovicë, Prishtinë dhe Rrafshi i Kosovës

Stacioni	Muajt												Vjet.
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Mitrovicë	-0.2	2.3	6.3	10.9	15.7	18.2	20.1	19.3	16.5	11.4	6.3	1.9	11
Prishtinë	-1.4	1.2	5.1	9.9	14.7	17.8	19.8	19.6	15.9	10.3	5.3	0.3	9.9

Rrafshi i Kosovës	-1	1.3	5	10	15	18	20	19	16	11	6	1	10
--------------------------	----	-----	---	----	----	----	----	----	----	----	---	---	----

Bazuar në të dhënat statistikore mund të konkludohet se temperaturat mesatare mujore variojnë nga -1.0 ° C në janar në 20.0 ° C në korrik.



Grafiku 1: Shpërndarja vjetore e temperaturave të ajrit

4.3.2. Reshjet

Reshjet janë një nga elementët klimatikë të cilët përcaktojnë karakteristikat klimatike të një zone. Faktorët që ndikojnë në karakteristikat e reshjeve janë, vendndodhja, distance nga deti dhe orografia. Në tabelën me poshtë jepen reshjet për disa stacione meteorologjike të ndodhura në afërsi të zonës ku do të ndërtohet impianti.


Në bazë vjetore në Mitrovicë bien afërsisht 591mm shi, pak më shumë bie në Prishtinë 599mm, ndërsa në Rrafshin e Kosovës 784mm në vit. Bora vrojtohet rregullisht në dimër, ndërsa kohëzgjatja e mbulesës me borë është relativisht e vetëm 16.4 deri 22.5 ditë. Zgjatja mesatare vjetore e zënies së diellit për shkak të ndikimeve orografike është më e vogël se sa mesatarja për Kosovën dhe është 1972 orë nga e cila në korrik 293, 6 orë ose 72,1 % diell në vit.

Tabela 2: Sasia mesatare e reshjeve (mm)

Stacioni	Muajt												Mes. vjet.
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Mitrovicë	40	36	38	49	58	63	49	41	44	44	72	57	591

Prishtinë	38	36	38	52	68	60	53	44	42	45	68	55	599
Kosovë	65	55	58	65	77	73	58	49	55	60	89	80	784

Në Kosovë vërehen disa lloje reshjesh si shiu, bora dhe breshëri. Sasia e reshjeve rritet me rritjen e lartësisë nga niveli i detit si dhe në drejtimin Lindja-Perëndim. Sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë muajve janar, shkurt, mars dhe tetor, ndërsa sasia më e vogël në muajt qershor, korrik dhe gusht. Sasia më e lartë e reshjeve vjetore është regjistruar në Gjakovë (1,027mm) ndërsa më e ulët në Klinë (822mm).



Grafiku 2: Shpërndarja vjetore e temperaturave të ajrit


4.3.3.Hidrografia

Komuna e Mitrovicës, në përgjithësi ka pasuri të mjaftueshme ujërash. Lumenjtë kryesorë janë: Ibri, Sitnica, Lushta dhe Trepça. Ibri hyn në territorin e Kosovës 10 km poshtë fshatit Ribariq. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës në territorin kosovar është 3800 km². Gjatësia e përgjithshme është 280 km, por vetëm 85 km është gjatësia që përshkon Kosovën (rreth 15 km komunën e Mitrovicës). Pellgu ujëmbledhës i përket Moravës Perëndimore. Deri në Mitrovicë ka drejtim VP – JL, ku bashkohet me lumin Sitnica. Lugina në këta sektorë është e ngushtë. Lumi i Ibrit ka këto degë: Sitnica, Lushta, Trepça, Bistrica etj. Lugina e Ibrit ka peizazh piktoresk. Përgjatë kësaj kalojnë rrugë komunikacioni, ku më kryesorja është magjistralja e Adriatikut, e cila lidh Mitrovicën me Malin e Zi. Që nga lufta e fundit (1999) qarkullimi nëpër të është zvogëluar shumë. Një degëzim tjetër i rrugës lidh Rashkën me Kralëvën. Sasia mesatare vjetore e ujit në pellgun e ujëmbledhësit të lumit të Ibrit është 1.146,33 milion m³. Thellësia e ujit është e ndryshme për arsye se Ibri e ka formuar shtratin e vet në shtresa të ndryshme gjeologjike. Në zonën kodrinore, me qëllim të përmirësimit të regjimit të rrjedhjes së lumit Ibër dhe shfrytëzimit racional dhe kompleks të ujërave të tij, është krijuar Liqeni i Ujmanit (Gazivoda), vëllimi i ujit të të cilit është 390.000 000 m³. Uji i tij është planifikuar të përdoret, pos për pije, edhe për ujitje. Me këtë potencial të mjaftueshëm

hidrografik është ndërtuar Liqeni i Gazivodës, i cili është ndërtuar në sistemin e Ibrit dhe ka fuqi të vendosur 34 Mw. Afër vendit ku derdhet në Ibër, Sitnica merr lumin e Trepçës (14 km), i cili buron në Shalë të Bajgorës. Lumi Lushtë (19 km) është degë e djathtë e Ibrit dhe buron në kodrën e Lubovecit (800 m) dhe kalon nëpër grykën e vet të prerë në gëlqerore në mes të kodrinave të Bajrit e të Shipolit dhe, duke kaluar nëpërmes qytetit (pjesa nga ura e Lushtës e deri në derdhje është e mbuluar dhe mbi të cilën kalon rruga e asfaltuar mespërmes qytetit) derdhet në Ibër. Në Lushtë afër Gurrës së Brabanikut, në sipërfaqen e tokës vrujon një burim uji të thartë sulfurik nën presionin e gazrave të brendshme që gjenden nën horizontet gëlqerore.

Sitnica është lumi kryesor në Fushën e Kosovës. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 286 m². Relievi i këtij pellgu është i butë. Gjatësia e lumit është 110 km dhe ndodhet tërësisht në territorin e Kosovës. Si pikënisje e lumit shërben burimi i Zhegovcit, i cili ndodhet në malin me të njëjtin emër (në pjesën jugore të Kosovës). Lumi i Sitnicës derdh në atë të Ibrit mesatarisht 15 m³/s. Është lumë kryesisht fushor, ndaj rrjedhja e tij është e qetë, shtrati është i cekët e me meandrimë. Gjatë vërshimeve lumi del nga shtrati dhe e ndërron atë.

Në afërsi të lokacionit ku do të operoj *Impianti për Deponimin e Materialeve Zjarrrduruese të përdorura dhe bluarja e tyre*, përkatësisht në përfundim të tij, në një distancë prej 700m rrjedhe lumi Stnica, e më në veri të tij, në një distancë prej 1400m rrjedhe lumi Ibër.



Harta 7: Rrjeti hidrografik i zonës

4.3.4. Flora

Treva e Mitrovicës është mjaft e pasur me bimësi. Ajo ka sipërfaqe të mëdha pamjesh të ndryshme. Pos arave, livadheve, kullosave dhe sipërfaqeve malore, ku rriten bimë e drunj të ndryshëm, treva e Mitrovicës, një pjesë e rrethinës është e zhveshur. Pyje më të larta gjenden në Shalë të Bajgorës, kurse pjesa tjetër është sipërfaqe e pyjeve të degraduara, shkurrajat, çufrrajat, që rriten spontanisht. Prej drunjve rriten: ahu, qarri, bungu, pisha, plepi, shëlgjja. Në Shalë të Bajgorës, për shkak të klimës, dimrave të gjatë e të ashpër e verërave të shkurtra e të freskëta, pos patates e tërshërës, të lashtat e tjera nuk rriten as nuk kultivohen.

Komuna e Mitrovicës ka një pozite të mirë gjeografike me një hidrografi të pasur dhe shtriye mjaft të madhe gjeografike, e cila përfshinë zonat mesatarisht të larta dhe zonal e ulëta të terrenit. Në këtë komunë, sa i përket fitodiversitetit lidhur me llojet e bimëve këtu kemi mjaft larmishmerie të bimeve nga ato barishtore njëvjeçare deri te ato shumëvjeçare dhe drunore apo brezat të pyjeve. Nga brezi i shpërdhit me qarr (*Quercus fraietto* dhe *Quercus cerris*) shkon deri te brezi i ahut dhe shkozës. Brezi i pyjeve të shpërdhit me qarr bungbut janë brezi me i dëmtuar nga faktori njeri. Vlen të theksohet se, përveç faktorëve tjerë, në dëmtimin e bimësisë pyjore ka ndikuar edhe hapja e rrugëve pyjore

Ndërkaq në zonat e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqërime mjaft të mëdha dhe të begatshme me lloje. Megjithatë toka e butë buzë Ibrit e Sitnicës etj. është mjaft pjellore dhe kultivohet gruri, misri, tërshëra, thekra, elbi, pjepri, shalqini, speci, lakra, trangulli, jonxhja etj.

Po ashtu në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin ruderal përgjatë rrugëve dhe vendbanimeve por, edhe barërat e këqija të cilat gjenden në tokat djerrina, në kufi të parcelave dhe në afërsi të gjerdheve.

4.3.5. Zoodiversitetit

Dikur treva e Mitrovicës ka pasur një faunë mjaft të pasur. Në zonat kodrinore dhe malore kanë jetuar: ujku, dhelpra, lepuri, vjedulla, ariu, derri i egër, sorkadha, pula e egër. Prerja e pyjeve pa kriter ka bërë që numri i tyre të bie shumë. Regjioni i Shalës së Bajgorës, dhe jo vetëm ai, ofron kushte për zhvillimin e gjuetisë dhe të turizmit të gjuetisë. Në regjionin e Mitrovicës në periudhën e fundit, për shkak të ndotjes së rrethit ekologjik, janë rralluar edhe kafshët shtëpiake. Numri i lopëve, deleve, dhive, kuajve, buallicave etj. ka rënë shumë. Ka rënë shumë edhe numri i shpezëve: pulave, patave etj. Dikur në lumenjtë e Mitrovicës (Ibër e Sitnicë) ka pasur shumë peshq. Përgjatë këtyre lumenjve është peshkuar, mirëpo sot, për shkak

të ndotjes së ujit, numri më i madh i peshqve është zhdukur. Në lumin Ibër dhe Stnicë gjinden shumë lloje të peshkut si krapë, ngjila, mlyshi, trofta, mrena, sykuqi, pellemza, linjaku etj. mirëpo janë shumë të rrezikuara për shkak të ndotjes së lumenjve nga Obiliqi dhe gurëthyesit në rrethin e Mitrovicës dhe nxjerrjes së rërës në këto dy lumenj.

4.4.Aspektet kryesore të gjendjes aktuale mjedisore

Të dhënat e mëposhtme i përkasin gjendjes së tanishme mjedisore në komunën e Mitrovicës. Qëllimi kryesor i paraqitjes së të dhënave baze është të identifikojë gjendjen mjedisore në ballafaqim me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të hartës zonale komunale të komunës së Mitrovicës në lidhje me investimin e propozuar. Impaktet potenciale të zhvillimit të HZK-se mund të vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e dokumentit nëpërmjet indikatorëve të gjendur-të supozuar sasiore ose cilësore. Esencialisht, gjendja mjedisore e komunës së Mitrovicës karakterizohet nga përshkrimi i receptorëve mjedisore, siç kërkohet nga direktiva e VNM-së, të përbashkuara më poshtë:

- Popullsia dhe Shëndeti publik;
- Fitodiversiteti dhe Zoodiversiteti;
- Zonat e mbrojtura të natyrës;
- Cilësia e ajrit
- Bezdisjet- zhurma kundërmimi pamjet e pa këndshme;
- Faktorët klimatik, ndryshimet klimatike;
- Uji në përgjithësi;
- Toka bujqësore dhe peizazhi;
- Asete materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);
- Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike);
- Trashëgimia natyrore (Zonat dhe monumentet e mbrojtura natyrore).

4.4.1.Popullsia

Komuna e Mitrovicës përbëhet nga qyteti i Mitrovicës dhe 45 fshatra. Komuna e Mitrovicës ka shënuar rritje të konsiderueshme të popullsisë prej vitit 1948, mirëpo migrimet e shumta e kanë në rritjen e ngadalshme të numrit të popullsisë. Numri i popullsisë në zonën e mbuluar gjatë regjistrimit të vitit 2011 është 85 701 banorë. Në zonat rurale jetojnë 24.698, ndërsa 61.003 në zonën urbane. Mesatarja e familjes është 4.47 anëtarë.

Tabela 3: Numri i popullsisë sipas vendbanimeve

	Vendbanimet	Nr. banorëve		Vendbanimet	Nr. banorëve
1	Bajgorë	1098	24	2 Korriku	1740
2	Bare	841	25	Qendra	12012
3	Batahir	0	26	Ilirida	8432
4	Broboniq	1023	27	Zhabar	8474
5	Gushac	475	28	Rrzhan	0
6	Kaçandolll	119	29	Selac	164
7	Kçiq i Madh	3965	30	Shupkovc	1517
8	Kçiq i Vogël	1365	31	Stantërg	1008
9	Koprivë	55	32	Suhodoll	224
10	Koshtovë	1701	33	Suhodoll	789
11	Kovaçicë	27	34	Svinjarë	668
12	Kutlloc	241	35	Tërstenë	163
13	Lisicë	519	36	Tunel i Parë	1010
14	Magjerë	637	37	Vaganicë	1999
15	Lushtë	55	38	Vërbnicë	313
16	Mazhiq	253	39	Vidishiq	249
17	Melenicë	475	40	Vidomiriq	195
18	Ofqar	0	41	Vinarc i Epërm	362
19	Pirq	511	42	Vinarc i Poshtëm	959
20	Rahovë	396	43	Vllahi	271
21	Rashan	364	44	Zabërxhë	70
22	Rekë	224	45	Zasellë	376
23	Ura e gjakut	6070	46	Zijaqë	17

Territori Administrativ i komunës së Mitrovicës është i pozicionuar në veri të Rrafshit të Kosovës dhe mbulon sipërfaqen prej 330.2 km². Dendësia e popullsisë është 260 b/km², ndërkaq dendësia mesatare e popullsisë në vitin 2011 në shkallë vendi ishte 177 b/km². Komuna e Mitrovicës përfshinë 3.03% të territorit të shtetit. Popullsia e disa vendbanimeve sidomos ato afër rrugëve vazhdon të rritet me ritme më të larta, rritje e cila ndikon drejt për drejt në zgjerimin e zonave të banimit drejt zonave me rrezikshmëri mjedisore. Për shkak të kushteve të jetesës vërehet se familjet e reja, përgjithësisht, tentojnë të vendosen në disa vendbanime si Mitrovicës, Vushtrri dhe Prishtinë etj., gjë që kërkon përmirësime të rëndësishme infrastrukturore në to, më shumë energji, ujë, rrugë, shkolla, kopshte, etj.

4.4.2.Shendeti

Ndikimet në shëndetin e publik për VNM, janë ato të cilat lindin si pasoje e bashkëveprimit me receptorët mjedisore (komponente mjedisore të tilla si ajri, uji apo toka) nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit me njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para se gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisore. Dendësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja e hapësirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, përkeqësimin e parametrave mjedisore të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime më të larta për mbrojtjen e shëndetit.

Në komunën e Mitrovicës, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF dhe QMF dhe spitalit të përgjithshëm.

4.4.3.Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin

Më poshtë, janë identifikuar disa ndikime që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Ndërtimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe menaxhimi i mbetjeve.
- Mbrojtja e vegjetacioneve autoktone;
- Mbrojtja e zonave të llojeve bimore endemike;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;
- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;
- Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore të pellgut;
- Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit

4.4.4. Veçori natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen

Te pjesa e gjendjes ekzistuese të komunës janë paraqitur mjaft të dhëna për veçorit natyrore dhe karakteristikat tjera natyrore.

Me zgjerimin e disa vendbanimeve janë të njohura edhe disa përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Zhvillime dhe ndërtimet edhe në disa zona sensitivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe gjeologjik. Zhvillimet dhe ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcënuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustruhet në disa nga shifrat që mundë të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytëzimi i tokës në vitet e më hershme dhe tani. Shumëfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të toke bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethe, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një tërësie pejsazhesh e gjelbërimit.

4.4.5. Zonimi i territorit të komunës

Duke u bazuar në tipologjinë e vendbanimeve, popullsitë, infrastrukturën shoqëruese arkitekturat, gjeomorfologjitë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Mitrovicës me HZK janë trajtuar si më poshtë:

- Zona ekonomike dhe industrisë;
- Zona e bujqësisë;
- Zona e hapësirave publike;
- Vendbanimet;
- Zonë Pyjore.

HZK-ja i ka identifikuar dhe trajtuar duke i destinuar si tokë bujqësore, tokë pyjore zona të mbrojtura natyrore dhe zona tjera të mbrojtura, zona për infrastrukturë hidrografike dhe infrastruktur tjetër.

HZK gjithashtu ka identifikuar zonat turistike për të gjithë llojet e turizmit të mundshëm në komunën e Mitrovicës kurse nuk janë të prezantuar në hartën e turizmit.

4.4.6. Zonat e mbrojtura

HZK-ja ka evidentuar gjithashtu zonën ku përfshihen zonat karakteristike me vlera të trashëgimisë kulturore -historike, peisazhike, mjedisore e turistike të Komunës. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat cenojnë identitetin e zonës.

Objektet ekzistuese të zonës mund të restaurohen vetëm në kushte të cilat i japin institucionet kompetente, duke mos cenuar identitetin e tyre. Zona e projektit për *“Impianti për Deponimin e Materialeve Zjarrduruese të përdorura dhe bluarja e tyre”*, në Mitrovicë, ndodhet jashtë zonave të mbrojtura dhe se nuk i atakon në asnjë mënyrë.

4.4.7. Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale

Zona industrial planifikohet të jetë lokale, dhe do zhvillohen kryesisht ku tashme është krijuar një bërthamë e një zone industriale në qytet ose aty ku vërtet ekzistojnë kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio-ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me HZK dhe duhet propozuar masat mjedisore.

4.4.8. Pyllëzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e blerta dhe të pushimit

Komunën e Mitrovicës sikurse në gjitha komunat tjera të Kosovës zhvillimet nuk i kanë favorizuar pyjet dhe zhvillimin e tyre, sidomos pyjet e zonave të ulëta (Shpardhit me qarr). Shumë nga zonat e gjelbërta, zonat rekreative natyrore, në shumicën e rasteve veihen para shkatërrimit total të tyre, si pasojë e prerjeve ilegale, djegieve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës. Hapësira pyjore dhe zonat e shkurreve dhe kullosat janë planifikuar në HZK. Deri tani shumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund të organizohen pushime vikendi apo diçka të ngjashme.

Esenciale çka HZK-ja duhej ofruar është sigurimi i korridoreve të gjelbërta që do të zhvillohen të bashkëshoqëruara me ndërtimin e rrugëve të reja dhe atyre ekzistuese, korsive për këmbësorët dhe biçikletat dhe tampon zonave të zhvillimit industriale dhe tjera të ndjeshme, si dhe rritjen e fondit të gjelbërt në komunë.

4.4.9. Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik

HZK duhet të tregoj qartë në hartë vendet ku kemi erozion dhe çfarë shkalle të erozionit nëse kemi erozion shumë të fort ose të fort atëherë të merren rreptësisht masa për parandalimin e tyre, po ashtu duhet të tregoj për zonat e vërshimeve dhe masat të cilat duhet të merren kundër vërshimeve.

Pos tjerash duhet të merren parasysh:

- zhvillimi i zonës industriale duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hapësirat e banimit duke e precizuar qartë në hartë (pjesa grafike);
- zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas rivlerësimeve mjedisore;
- Zhvillimi i Pyjeve, hapësirave të gjelbërta, shiritave gjelbërues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan e sidomos në Planet Rregulluese dhe projekte duke vlerësuar raportet e ndërtimit.

5. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Lokacioni i **impiantit qe synon te ushtroj veprimtarin për; Grumbullit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve te tullave zjarrduruese (refraktare)**, “MIRECO” SH.P.K. ndodhet në Zonën Industriale te Trepçës ne qytetin e Mitrovicës, në zonën kadastrale Shupkovc të Mitrovicës, përkatësisht në ngastrën kadastrale nr. P-71208128-01090-1. Terreni i lokacionit karakterizohet me pjerrësi kontinuele, me rënie rreth 2%, me drejtim të rënies nga lindja në perëndim.

Prej vitit 1965 lokacioni ku do të operoj impianti kishte kaluar në zoni industriale në kuadër të shoqërisë aksionare “Trepça”, e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite. Për shkak të mos funksionimit zona në tërësi është mbuluar me gjelbërim, gjendje kjo e cila edhe aktualisht ekziston. Parcela në fjalë dhe hapësira për rreth janë hapësirë industriale e nuk janë toka bujqësore. Toka ekzistuese në lokacion si tërësi është me bazë zhavorrike me një shtrese humusore jo më të trashë se 5-10cm si rezultat i bartjeve të lymit ndër vite. Pra toka ekzistuese nuk konsiderohet tokë bujqësore me rendiment të kënaqshme.

Projekti parashih që në ngastrën e lartë përmendur të montohet ne objektin ekzistues **“Impiantin qe synon te ushtroj veprimtarin për; Grumbullit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve te tullave zjarrduruese (refraktare)”**, i specifikuar sipas planit të situacionit dhe organizimit të parcelës. Në lokacion parashihen të vendosen pajisjeve me përmbajtje në shërbim të funksionit të sipër cekur, me ndikim minimal rrethanor dhe me leverdi të theksuar socio-ekonomike për zonën dhe komunitetin.

Në impiant parashihen të punësohen 6 persona profesional për nevojat e funksionimit të impiantit dhe shërbimet përcjellëse. Projekti si tërësi ndërtimore nuk parashih as një dëmtim të florës dhe faunës në lokacion, **pasi që i tërë aktiviteti operativ do të kryhet në brendësi të objekteve industriale ekzistuese**. Pajisjet dhe përmbajtjet parashihen të vendosen mbi bazamentet stabile nga betoni në brendësi të hangarit, ndërsa si tërësi lokacione parashihet të jetë platformë zhavorrike e planifikuar dhe e rregullt, me mirëmbajtje permanente në shërbim të mos - ndotjes së ambientit dhe rrethinës.

5.1. Rruga për qasje në lokacion

Për qasje në lokacionin ku parashihet të operoj depoja për grumbullimin e materialeve zjarrduruese të përdorura dhe për lokacionet rrethore, qasja është përmes rrugës magjistrale “Albaniku” (rrugës ekzistuese).

5.2. Rrethoja e lokacionit

Rrethoja lokacionit është nga rrjeti i telit (metalike) më lartësi 1.6m, me shtylla përforcuese nga çeliku jo korrediv në distanca jo më të mëdha se 2 m. Rrjeti i telit rrethues është i dendur dhe jo korrediv. Në kuadrin e hyrjes është dhe porta hyrëse me gjerësi 4+4m (8m) me qasje nga skaji më verilindor i parcelës. Rrethoja si e tillë nuk pengon vizurat ambientale në zonë, pengon vetëm qasjet e personave të pa autorizuar në parcelë, njëherit edhe si siguri fizike e parcelës.

5.3. Masat gjatë fazës së para funksionimit-operimit

Para fillimit të **funksionimit-operimit** duhet të bëhet rrethimi dhe sinjalizimi i vendit të nderimit sipas praktikave dhe legjislacionit në fuqi. Puna përgatitore përfshinë pastrimin e terrenit-lokacionit të ngushte nga mbeturinat dhe gjësendet e dëmtuara.

Vendfunksionimi-operimi duhet të organizohet sipas skemave standarde të organizimit të operimi në funksion të mjeteve të cilat do të përdoren gjatë dinamikës së operimit si dhe sigurimit të personelit.

Në rast të krijimit të pluhurit do të merren masa gjatë këtyre punimeve që mos të përdoren mjete të vjetruara apo me defekte të cilat mund të emitojnë vlera të larta të zhurmës, që do të kishin efekte negative në mjedis.

Gjatë organizimit të vend të punës duhet të sigurohet qasje nga rrugët sekondare të automjeteve/mjeteve që do të përdoren në procesin e operimit, përfshirë qasjen për zjarrfikësit, në dy pika: në hyrje dhe në dalje të impiantit, si dhe qasjen drektë në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit konform nevojave.

6. PËRSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK

6.1. Tulla zjarrduruese

Tulla zjarrduruese i përket materialeve me rezistencë të lartë ndaj zjarrit. Tulla zjarrduruese silikate ka karakteristika të shkëlqyera të rezistencës së mirë ndaj korrozionit acid, përçueshmëri të madhe të nxehtësisë, rezistencë të lartë në temperaturë deri 1620°C.

Tulla zjarrduruese silikate përdoren kryesisht si materiale zjarrduruese për muret mbrojtëse të dhomës së koksit dhe djegësit në furrën e koksit, në furrën me vatër të hapur për prodhimin e çelikut, në furrën e shkrirjes së qelqit, si dhe në furrat e pjekjejeve. Tullat zjarrduruese gjithashtu mund të përdoren në hapësira ku nevojitet mbajtja temperaturës së lartë dhe në majë të furrës me vatër të hapur me acid, furrën e qeramikës, etj.

6.2.Reduktimi, Ripërdorimi, Riciklimi (3R)

Rritja e popullsisë, konsumi i tepërt dhe ndotja ndikojnë në jetesën e njerëzve dhe në mjedis. Reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimi janë procese sa të ndryshme, edhe të ngjashme. Megjithatë qëllimi është i njëjtë: ruajtja e një jetese të shëndetshme.

Reduktim i mbetjeve do të thotë veprimtaria efikase që të mos lejojmë lindjen e mbeturinave. Kjo arrihet përmes zbatimit të disa metodave të cilat kanë treguar mjaft efikasitet, siç janë:

- Blerjen në mënyrë të ndërgjegjshme për mjedisin;
- Prodhimin e vet produkte;
- Zgjedhjen e paketimit të ricikluar;
- Kursimin e energjisë, ujit, e kimikateve;
- Mos flakjen e artikujve;
- Zgjedhjen e produkteve me paketim minimal;

Reduktim do të thotë të zvogëlosh konsumin ose të blesh më pak, për të ulur përdorimin e resurseve të Tokës. Ulja e konsumit dhe e blerjeve të panevojshme, ul shkallën e përdorimit të materialeve dhe të energjisë, naftës dhe transportit.

Ripërdorimi është rikthimi i mbeturinave nëpërmjet qarkullimit në lëndë të parë natyrore. Ripërdorimi i materialeve ul konsumimin e energjisë së nevojshme për prodhimin e produkteve të reja. Rezultati: më pak ndotje dhe më shumë burime natyrore. Përpara se ta hidhni një produkt, mendoni se si mund ta ripërdorësh për një qëllim tjetër. Një shembull i tillë

mund të jetë përdorimi i tullave të një godine të shembur për të ndërtuar dekoracione ose ndonjë godinë më të vogël.

Riciklimi i referohet procesit gjatë të cilit një produkt përdoret për të krijuar diçka të re. Riciklimi nxjerr materiale të vlefshme nga ato që mund të konsiderohen si mbeturina, duke i kthyer në produkte të reja. Prodhimi i produkteve kërkon materiale, energji dhe kohë.

Në rastin tonë grumbullimi i tullave zjarrruduese dhe ridestnimi i tyre është proces i cili ndihmon dukshëm në mbrojtjen e ambient në një mënyrë që këto tulla nuk hedhen e ambient, pra nuk krijohen mbeturina, pastaj të njëjtat ripërdoren përmes një ridestnimi sipas nevojave të tregut.


Prandaj, reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimi formojnë një cikël të plotë që ruan burimet natyrore, redukton mbeturinat, energjinë e ndotjen dhe mbron planetin.

6.3.Punimet sipërfaqësore rreth lokacionit

Lokacioni ka rrugë për qasje nga pjesa verilindore. Rruga ekzistuese nga ana verilindore planifikohet të profilohet, të mbushet me zhavorr natyrale dhe në tërësi të jetë funksionale për lokacionin dhe tjerat për rreth, ndërsa profili në fqinjësi (jashtë rrethojës) planifikohet të jetë plotësisht natyral si ekziston aktualisht (para punimeve ndërtimore).

6.4. Përmbajtjet dhe pajisjet funksionale dhe teknologjike sipërfaqësore

Lokacioni i parapare për vendosjen e stabilimenteve dhe pajisjeve dhe pjesa sipërfaqësorë e jashtme ka sipërfaqe rreth 5.400. m²



Potential setup (2000 qm):

- Asphalt + concrete works (2k qm)
- Storage Boxes (6 pcs.)
- 2 social containers (office + sanitary)
- Sorting cabin (6-8 chutes) + buckets
- Jaw crusher
- BB-packaging
- 2 wheel loaders (also usable as forklifts)
- Storage capacities for BB

Figura 4: Projekti konceptual




Figura 5: Projekti ideor, urbanistik dhe konceptual

LEGJENDA

Location - Imjant facility, 30mX180m = 5400 m2

- ① Container 2.15x6.15x2.4m, office for staff - 2-8 people, 5kW,
- ② Container 2.15x6.15x2.4m, with tush/WC and wardrobe - staff of 6-8 people, 3kW,
- ③ Container 2.15x6.15x2.4m, Warehouse for logistic needs, 3kW,
- ④ External Toilet

⑤ External cistern for drinking water and hygienic needs

⑥ Accumulating septic tank with a capacity of 25m3

⑦ Well for sanitary and hygienic water, 2kW,

⑧ Scale for measuring loads at the entrance/exit, 4kW

⑨ Table of establishments for measuring weights

⑩ Warehouses (8x10.8 m) - Collection boxes for selected material

⑪ Conveyor heater

⑫ Sorting machine (Vibrating Sieve)

⑬ Mechanical filling of industrial bags with heated material

⑭ Depositing bags filled with burnt material, One bag = 1500 ~1800 Kg.

PROJEKTI IDEOR URBANISTIK & KONCEPTUAL

ARKITEKTURA
Ground Floor , P = 1:200

Kompleksi:
Implanti Përpunues - Riciklues i Materialeve
Zjarreduruese të Përdoruna
Lokation: Mitrovicë

6.4.1. Procesi i grumbullimit

Gjatë procesit të grumbullimit duhet të merren masat adekuate. Në vijim kemi një paraqitje më të detajuar të mënyrës së operimit të plotë në impiant. Funkzioni i rrjedhës së procesit parashihet të realizohet si në hapat në vijim (shih figurën e më sipërme nr. 4):

- Ardhja me kamionë e materialit për deponim përmes rrugës qasëse;
- Hapja e dyerve metalike pre hyrje në lokacion;
- Matja e materialit të sjellë në peshore “nr. 8” (me kamion transporti), përfshi tabelën komanduese “nr. 9”;
- Nga peshorja, materiali bartet dhe zbrazet në deponin e mbuluar, objekti “nr. 10”.




Figura 6: Objekti ku do të zhvillon funksioni impianti, hapësira ku grumbullohet materiali

6.4.2. Procesi i ndarjes-sortimit

Ky është objekti i hangarit në Trepçë. E gjithë veprimtaria zhvillohet brenda këtij hangarit që është me rreth 5400 m². Në këtë hapësirë pos grumbullimit bëhet edhe klasifikimi i tullave zjarrduruese. Më pas operimi zhvillohet përmes dy makinerive kryesore, makinës që bënë **sortimin e materialit**, i cili behet me dore dhe hidhet tek makina nr.2, pra në makinën e Thyerjes nëse është e nevojshme, nëse jo, materiali selektohet-vendoset në thasë-boksa të veçantë të ndarë për secilin material veç e veç.

Sortieranlage Edge




Figura 7: Makina e sortimit

6.4.3. Procesi i bluarjes-thërrmimi

Pas procesit të sortimit, nëse është e nevojshme bëhet edhe thërrmimi i tullave zjarrduruese. Këtë proces e kryen makina -Jaw Crusher- Gurthyes Mobil. Kapaciteti për një ditë në operacion me një ndërrim është përafërsisht 20 ton. Kjo makineri bënë thërrmimin e tullave zjarrduruese, pasi hapësira është e mbyllur dhe nuk ka aktivitetet të përditshëm, një herë (një ditë) në muaj apo dy here me se shumti. Makineria është mobile me rrota dhe mund të lëvizet nga një vend në tjetrin shumë lehtë. Shih foton e mëposhtme.



Figura 8: Makineria për bluarje-thërrmim

Materiali ngarkohet në hopperin e ushqimit përmes një ngarkuesi rrotullues. Një kanal vibrues e përcjell materialin më tej në një brez transportues. Materiali bie në thyesin e nofullës Kleemann. Këtu, materiali thyen në 0-40 mm dhe shpërndahet përmes një brezi tjetër transportues.




Figura 9: Koncepti si funksionon procesi përpunues i gurthyesit

6.4.4. Mbushja e thasëve

Pas procesit të sortimit apo të bluarjes vijon procesi i mbushjes së thasëve. Materiali i ardhur, nga deponia e mbuluar, futet në thasë dhe bartet me ekskavator “nr. 13”. (shih figurën e më sipërme nr. 4).

Materiali ngarkohet në lugën e ekskavatorit-ngarkuesit përmes një ngarkuesi rrotullues. Një Hink për mbushje - BB bosh është varur në pajisjen e pezullimit. Duke hapur manualisht rrëshqitësin fillon mbushja e Thaseve- BB-së. Shkalla e platformës tregon peshën aktuale, dhe kur arrihet pesha e duhur, fluksi i materialit ndalet duke mbyllur vrimën e poshtme mbushëse dhe e ndal platformën.

Materiali i selektuar vendoset në thasë si material final, vendosja në thasë bëhet përmes kallupit, ku thasët me peshë 1500Kg-1800kg përmes pirunorve barten deri në deponi të thasëve “14” të vendosur në një nivel dhe të renditur si në planimetri. Thasët si ngarkese finale, ngarkohen në kamion transporti dhe vendosen në peshore për matje “8” nga aty përmes derës dalin në rrugë për largim dhe drejt destinacionit final.




Figura 10: Mbushja e thasëve Big Bags

6.4.5. Kompleksi i kontejnerëve në lokacion

Në funksion të procesit të sipër cekur, vendosen dhe stabilitetit ndihmese administrative dhe logjistike, siç janë:

- Një kontejner sanitar “2” me dimensione 2.15mx6.15m dhe lartësi h=2.2m – për nevojat sanitare si tush kabina, WC për staf dhe garderoba për 6-8 persona;
- Një kontejner Administrativ "1" me dimensione 2.15mx6.15x2.2m, për akomodim të zyrës për 2 persona dhe tavolinës së takimeve për 6 persona;
- Një kontejner logjistik “3” me dimensione 6.15mx2.15mx2.4m, për deponim të pajisjeve dhe stabilimenteve manuale.
- Një llavabo sanitarë për nevojat në lokacion përfshi dhe hidrantin për mbrojtje nga zjarri;
- Bunari “7” lokal për nevojat për uji;
- Gropa lokale septike akumuluese “6” me kapacitet min. 25m³;

6.5. Furnizimi me ujë

Zona ekzistuese si tërësi (Lokacioni i gjere), në veçanti dhe zona e ngushtë (lokacioni i ngushtë) ekzistues, është i lidhur me sistemin e ujësjellësit të qytetit të Mitrovicës, që kryesisht shërbejnë për nevoja sanitare, të pijes, etj. Zona si tërësi kohë pas kohe me rastin e reshjeve të mëdha atmosferike vërehet nga ujërat e reshjeve atmosferike që vijnë nga lumi Sitnica.

Lokacioni nuk posedon as një lloj sistemi të ujitjes si nga rrjedhat sipërfaqësorë ashtu as edhe nga sistemet me gypa nëntokësor, lokacioni ekzistuese nuk ka as një sistem ujitje dhe në të ardhmen nuk parashihet që në lokacion si tersi (përfshi lokacionin e ngushte) të ketë ndonjë projekt për ujitje tokash.

6.6. Furnizimi me energji elektrike

Lokacioni i ngushtë si tërësi, si dhe ngastra nr. 01090-1 në veçanti, furnizohen nga rrjeti ekzistues i kompleksit industrial, i kyçur në rrjetin lokal elektrik (CEDS).

Furnizuar me energji elektrike nga rrjeti i elektroshtetërisë, janë të vendosura siguresat shkëmbore, si dhe do të realizohet mbrojtja nga prekje, i lidhur me tokëzimin e objekteve dhe trupave ndriçues të jashtëm. Nga kuadri kryesor shpërndarës do të bëhet shpërndarje e furnizimeve në objektet dhe makineritë përcjellëse.

Fuqitë elektrike të parapara për objektet dhe makineritë e objektit për riciklimin e janë të parapara si në vijim:

- Peshorja për matjen e ngarkesave të materialeve për dhe të ricikluara, do të furnizohet me kabllo NYY-J 5x2.5 mm², nga kuadri kryesor shpërndarës deri tek vendi ku është e vendosur, ku e njëjta ka fuqi elektrike prej 4.00 kW;
- Pajisjet për furnizim me ujë sanitar nga bunari, ku përfshihen pompat, filtrat dhe pajisjet tjera të nevojshme, do të furnizohen me kabllo NYY-J 3x2.5 mm². Fuqi elektrike e këtyre pajisjeve është 2.00kW;
- Kontejneri me tush/WC, gardërobë dhe pajisje tjera për nevojat e stafit, parashihet të ketë fuqi elektrike 3kW;
- Kontejneri për zyre parashihet të ngarkohet me fuqi elektrike prej 5 kW;
- Kontejneri depo për nevoja të logjistikes, ngarkohet me fuqi elektrike prej 3kW;
- Makinaria për thyerjen (thërrmimin) dhe separimin e materialeve për riciklim ka një fuqi prej 10kW, ku e njëjta punohet me kabull NYY-J 5x10mm²
- Ndriçimi i jashtëm i hapësirave të vendosur në shtylla metalike dhe në objektet tjera përcjellëse të punuar me kabllo NYY-J 4x16mm² dhe kabllo NYY-J 3x2.5 mm², ka ngarkesë elektrike me fuqi prej 3kW.

Fuqia totale elektrike me të cilën ngarkohet kompleksi më të gjitha përmbajtjet për riciklimin e materialeve industriale zjarrruduese të përdorura ka një kapacitet të fuqisë së njëkohshme prej 30kW.

6.6.1. Trupat ndriçues

- Për ndriçimin e këtij impianti do të përdoren trupa ndriçues LED për shkak të performancave teknike që kanë;
- Furnizimi i trupave ndriçues të brendshëm dhe të jashtëm të objektit realizohet me kabllo NYM 3x1.5 mm² të vendosura në kanale plastike, pasi që i tërë sistemi i instalimeve elektrike në hapësirat e brendshme të objektit do të jetë i tipit OG;
- Në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike, ndriçimi do të punon me anë të atij emergjent me trupa ndriçues me baterinë autonome dhe automat për rimbushje çdo tre orë;
- Ndërprerësit janë të tipit OG 10A/250V të cilët do të vendosen në pozita sipas kushteve teknike dhe funksionale (Lartësia e këtyre ndërprerësve është 1.2 m nga dyshemeja si dhe distanca minimale 15cm nga dera);
- Furnizimi i ndërprerësve të objektit është realizuar me kabllo PPy 3x1.5 mm² të vendosura në kanale;
- Mbrojtja e kabllor në këta ndërprerës do të bëhet me siguresa automatike 10A;
- Prizat njëfazore janë të tipit OG 16A/250V, të montuara në pozita sipas kushteve teknike dhe funksionale (Lartësia e këtyre ndërprerësve është 0.4 m nga dyshemeja si dhe distanca minimale 15cm nga dera);
- Prizat trefazore janë po ashtu priza trefazore të tipit OG;
- Lartësia e pozitës së vendosjes së prizave në ndërtesë është 40cm nga dyshemeja si dhe në distancën minimale 15cm nga dera;
- Mbrojtja e kabllor në këto priza njëfazore dhe trefazore duhet të bëhet me siguresa automatike 16A.

Sistemi për mbrojtje nga shkarkimet atmosferike (rrufepritësi) dhe tokëzimi i këtyre shkarkimeve do të punohet sipas standardeve teknike, ku në perimetrin gjatësor të objektit të depos për *grumbullimin e materialeve zjarrduruese të përdorura dhe bluarja e tyre*, do të punohet ndriçimi i jashtëm. Ndriçimi i cili do të punohet e shtylla metalike do të ketë të kyçur edhe tokëzimin e shkarkimeve atmosferike me shirit të zinkuar FeZn 25x4mm². Po ashtu edhe kontejnerët për zyre, për tush/WC dhe gardërobë, si dhe kontejneri i depos për nevoja të logjistikës do të kenë të shpërndarë shirit FeZn 25x4mm përgjatë perimetrit të tyre. Të gjitha objektet metalike dhe makineritë do të lidhen në shiritin FeZn 25x4mm.

Pas realizimit të këtyre punimeve do të bëhen matjet e rezistencës së tokëzimit dhe se rezultatet e këtyre matjeve duhet të jenë më të vogla se 4 Ω/m.

Bazuar ne raportin e sipër cekur të instalimeve elektrike të këtij kompleksi, mund të konkludohet se kompleksi në fjalë i plotëson kriteret elektroenergjetike dhe si i tille mund të funksionojë normalisht.

6.6.2. Masat për kursimin e energjisë

Që të zvogëlohet përdorimi i energjisë në impiantin, duhet të instalohen trupat ndriçues me efecient të lartë ekonomike, të cilit do të kursejnë në masë të madhe shfrytëzimin e energjisë (sidomos trupat ndriçues të teknologjisë LED). Gjithashtu konstruksioni i objektit do të jetë në përputhje me standardet për depërtimin e temperaturës, dhe do të ketë izolim që i përshtatet plotësimit të standardeve të kërkuara për stabilitetin e temperaturës. Madhësia e dritareve në këtë objekt do të jetë e përshtatshme dhe në këtë mënyrë do të shfrytëzohet drita natyrale duke i ikur shfrytëzimit të ndriçimit artificial.

Arkitektura - duhet të kihet parasysh që kontejnerët nëse merren të parafabrikuar (të gatshëm) të jenë me koeficient të lartë të rezistencës termike, ose nëse ndërtohen në vend të përdoren materiale adekuate që koeficienti i ruajtjes së temperaturës të jetë sa më i lartë. Pajisjet elektrike që përdoren në deponi të jenë me efijencë të lartë (A+++).

6.7.Qasja në sistemet e kanalizimit

Lokacioni i zgjeruar, gjithashtu dhe parcela nr. 01090-1, Ekziston vetëm rrjeti i kanalizimit të kompleksit industrial që nga e kaluara. Për nevojat lokale dhe veprimtarinë e planifikuar nuk është e nevojshme dhe e domosdoshme që të aplikohet sistemi me gropë septike akumuluese që do të përfshijnë akumulimin e ujërave të ujërave të zeza dhe ujerave tjera teknologjike në lokacion. Reshjet atmosferike parashikohet që të përbihen (thithen) nga toka dhe tereni ekzistues zhavorrik.

7. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS

Ky seksion vlerëson mënyrën në të cilën projekti do të ndërveprojë me elementë të mjedisit fizik, ekologjik ose social për të pasur ndikime te burimet/receptorët. Është organizuar sipas fazave të ndryshme të ciklit jetësor të projektit për të kuptuar rreziqet dhe ndikimet që lidhen me secilën fazë.

Gjithashtu, kohëzgjatja e ndikimit është një tjetër tipar që ka një rëndësi të veçantë në vlerësimin e ndikimeve në mjedis. Nëse prania e një ndikimi zgjatet në mjedis, akumulimi dhe akumulimi bio ka më shumë të ngjarë të ndodhë.

Kohëzgjatja e ndikimeve në mjedis u vlerësua në tre nivele:

- Ndikimi afatshkurtër: Këto ndikime vlerësohen kur koha e pranisë së ndikimit në mjedis është e shkurtër;
- Ndikimi afatmesëm: Vlerësohet ndikimi që do të jetë i pranishëm pothuajse gjatë gjysmës së kohëzgjatjes së fazës së operimit;
- Ndikimi afatgjatë: Vlerësohen ndikimet që janë të pranishme gjatë gjithë fazës së ndërtimit ose operimit.

Aktualisht ndikimet e identifikuar në fazën e ndërtimit dhe operimit dhe vlerësimi i karakteristikave të tyre (lloji, kohëzgjatja dhe rikthimi i gjendjes së mjedisit në gjendjen e mëparshme) përshkruhen në më poshtë.)

Ndërveprimet mjedisore të identifikuar që kanë gjasa të sjellin ndikime të ndjeshme:

Tabela 4: Ndërveprimet mjedisore të identifikuar

Burimi/receptori	Ndikimet e mundshme të ndjeshme:
Cilësia e ajrit	• Emetimet e pluhurit për shkak të lëvizjes së makinerive dhe automjeteve; • Emetimet në ajër për shkak të operimit të gjeneratorëve me naftë dhe makinerive.
Cilësia e zhurmës në mjedis	• Rritje e nivelit të zhurmës për shkak të lëvizjes së automjeteve dhe makinerive;
Përdorimi i tokës	• Ndryshimet e përkohshme në përdorimin e tokës për shkak të ndërtimit të zyrës së përkohshme në terren dhe zonës së depozitimit të materialit.
Ndikimet në hidrologji dhe tokë	• Sedimentimi në trupat ujorë të afërt për shkak të erozionit të tokës dhe uljes së cilësisë së tokës për shkak të humbjes së mbulesës së bimësisë; • Magazinimi dhe trajtimi i materialeve të rrezikshme dhe mbetjeve të krijuara nga përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit dhe mirëmbajtja e tyre mund të çojë në ndotje të tokës për shkak të rrjedhjeve/derdhjes.
Mjedisi ujor	• Përkeqësimi i cilësisë së ujit për shkak të punimeve në ndërtim; • Shkarkimi aksidental i hidrokarbureve nga automjetet e transportit dhe të punës dhe ndotja për shkak të derdhjes së naftës, lubrifikantit dhe mbetjeve të rrezikshme.

	• Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për shkak të depozitimit të papërshtatshëm të ujërave të zeza në terren;
Shëndeti dhe Siguria në Punë	• Rritje e rreziqeve të shëndetit në punë për shkak të ndotjes nga pluhuri dhe zhurma; • Rritje e rrezikut të sigurisë për shkak të përdorimit të gabuar të makinerive;
Ekologjia lokale	• Ndikimet nga aktivitetet operative dhe të ndërtimit tek habitatet dhe speciet, në mënyrë specifike ndikimet tek speciet që bëjnë strofulla, dhe efekti i depozitimit të sedimenteve dhe ndotësve në trupat ujorë përreth. • Ndikimet tek shpendët duke u përplasur potencialisht me makineritë.
Komunitetet lokale në afërsi të vendit të projektit dhe ekonomia lokale	• Shëndeti social dhe komunitar - rritja e përhapjes së sëmundjes që vjen nga fluksi i punëtorëve të ndërtimit dhe lëvizja e trafikut të rënduar. • Ndikimi në mundësinë e punësimit lokal.

8. PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS

8.1. Efektet vizuale (peizazhi)

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të përcaktuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin objekt-mjedis. Në përgjithësi zona ku do të operoj impianti është një zonë industriale. Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Sipas projektit të planifikuar nga ana e arkitekteve ky objekt nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar pasi që i tërë operimi dhe funksioni i impiantit do të kryhet në brendësi të objekteve industriale ekzistuese, të cilat janë marr me qera. Peizazhet e bukura gjenden disa km larg në pjesën verilindore të këtij objekti.

Ndjeshmëria e receptorëve vizualë varet nga situata lokale. Receptorët e mundshëm të peizazhit në rajon përfshijnë banorët vendas, udhëtarët dhe turistët. Duke qenë se lokacioni është një zonë industriale, ekziston nevoja për një projektim që respekton sa më shumë të jetë e mundur peizazhin ekzistues. Gjatë fazës së operimit, peizazhi përgjatë zonës së projektit do të mbetet i paprekshëm.

Aktivitetet e operimit do të jenë:

- lëvizja e automjeteve të rënda për transportin e lëndëve të para;
- lëvizja dhe përdorimi i automjeteve të rënda të punës si ekskavatorë, vinça etj.;
- ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve që do të përdoren si lëndë e parë.

Përveç kësaj, mjedisi vizual i krijuar gjatë periudhës së operimit do të jetë i përkohshëm, me një kohëzgjatje afatshkurtër, të kufizuar vetëm në fazën e n operimit. Për kohëzgjatjen e operimit, ndikimet vizuale do të jenë thuajse të papërfillshme.

Gjatë fazës operationale të impiantit, ndikimi në peizazhin e zonës është pjesërisht i dukshëm. I gjithë projekti do të jetë i rrethuar me një gardh të përshtatshëm për sigurinë e banorëve dhe specieve të faunës në zonat përreth. Atje ku është mundur, do të ketë të mbjella të përshtatshme, kështu që projekti do të përmirësojë peizazhin, në krahasim me atë që ka qenë deri më tani. Megjithatë, duke marrë parasysh zonën me të gjithë përbërësit e saj si trafikun rrugor, materialin e përdorur, mënyrën e ndërtimit etj., ndikimi i projektit në peizazhin e zonës pritet të jetë i papërfillshëm.

8.2.Vlerësimi i ndikimit në mjedis

Projekti i planifikuar të realizohet në lokacionin nr. 01090-1, nuk parashihet të ketë ndikim negativ në mjedis dhe rrethine. Aspekti i ndikimeve të mundshme mjedisore është analizuar në veçanti në kapitujt e ardhshëm.

8.2.1. Ndotja e ajrit

Gjatë fazës së përgatitore, do të shkaktohen ndikime të përkohshme në cilësinë e ajrit në afërsi të zonës së projektit. Këto ndikime shkaktohen nga sa vijon:

- Transporti i materialeve;
- Transporti i personelit që i përket fazës së ndërtimit dhe operimit;
- Përdorim i makinerive dhe vendeve të punës

Ndotësit e ajrit të emetuar gjatë fazës së montimit të impiantit lidhen me emetimet e pluhurit, për shkak të gërmimeve, punimeve tokësore dhe lëvizjes së automjeteve dhe makinerive të rënda, si dhe emetimeve të shkaktuara nga përdorimi i motorëve të makinerive, automjeteve të rënda dhe veturave.

Emetimet e pluhurit mund të shkaktojnë probleme serioze, veçanërisht kur projekti ndodhet afër zonave të banuara. Në këtë rast lind nevoja për masat e duhura zbutëse për të minimizuar këto ndikime në mjedis.

Gjatë lëvizjes së automjeteve me naftë, ndotësit më problematikë të ajrit që emetohen janë: PM10 dhe PM2.5, CO₂ nga djegia, CO nga djegia e papërshtatshme, hidrokarburet (HC ose VOC) të cilat krijohen gjithashtu nga djegia e papërshtatshme dhe NO_x të cilat prodhohen në temperatura të larta të djegies.

Gjatë fazës operationale të impiantit do të kemi emetime të ndotësve të ajrit nga:

- Emetimet e ajrit për shkak të përdorimit të automjeteve që përdoren për transportimin e tullave zjarre duresë.
- Emetimet e ajrit nga procesi i grumbullimit të këtyre mbetjeve.
- Emetimet e ajrit për shkak të procesit të sortimit, nëse është e nevojshme bëhet edhe thërrmimi i tullave zjarrruduese.

8.2.2. Ndotja e ujit

Gjatë fazës operationale nuk do të ketë ndikime të dukshme për sa i përket ndryshimeve gjeologjike dhe hidrogeologjisë. Punimet që do të kryhen në impiant do të jenë punime të

vogla dhe do të kryhen kryesisht mbi sipërfaqe të betonizuara të objektit. Projekti nuk përfshin hapjen e kanaleve në terren ose hapje tunelesh.

Nuk do të ketë ndryshime të mundshme në modelet hidrologjike si pasojë e aktiviteteve të operimit. Operimi nuk do të destabilizojë tokat që me shumë mundësi mund të çojnë drejt erozionit të tokës gjatë reshjeve të mëdha të shiut dhe sedimentimit në kanalet kulluese dhe kanalet e ujitjes së zonës. Ekziston mundësia të ndikojë në uljen e cilësisë së ujit për shkak të rritjes së sedimentit në kanalet kulluese. Ndikime të tjera lidhur me to mund të përfshijnë ngjarje aksidentale (derdhje, rrjedhje dhe shkarkime të pakontrolluara) për shkak të pranisë së materialeve të rrezikshme në vend, përfshirë karburantin. Për më tepër, ruajtja dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme brenda terrenit mund të paraqesin rreziqe për ndotje të mundshme të tokës, veçanërisht në rastet e praktikave jo të duhura të menaxhimit të mbetjeve. Në këtë rast, kullimi dhe menaxhimi efikas i terrenit do të jetë çelësi për të reduktuar ndikimet e mundshme.

Në këtë zonë gjenden disa burime ujore dhe trupa ujqorë që mund të preken nga operimi i këtij projekti. Vetë projekti do të kujdeset për të përmirësuar menaxhimin e këtyre ujërave, kryesisht të ujërave nëntokësorë. Materialet dhe arkitektura që do të përdoren në këtë projekt do të jenë të favorshme për mjedisin. Punët e operimit të *“Impianti për Deponimin Materialeve Zjarrduruese të përdorura”*, nuk ndikojnë në burimet ujore të së gjithë zonës së projektit. Ndikimet gjatë fazës së operimit-funksionimit (vetëm në rastet aksidentale) përbëhen nga:

- Përkeqësimi i cilësisë së ujit për shkak të punëve operacionale;
- Shkarkimi aksidental i hidrokarbureve nga automjetet e transportit dhe të punës.

Të dyja këto ndikime të mundshme prekin të gjithë trupat ujqorë që ndikohen nga projekti. Në afërsi të *“Impianti për Deponimin Materialeve Zjarrduruese të përdorura”*, trupat ujqorë kryesorë pranë projektit janë:

- lumi Sitnica;
- lumi Ibër dhe
- lumi Trepça.

Sipas projektit, nuk do të ketë asnjë ndërprerje të projekteve në këto trupave ujqorë. Gjatë operimit-funksionimit nuk do të ketë asnjë ndikim në cilësinë e vetë ujit, duke marrë parasysh që punimet do të jenë sipërfaqësore me materiale natyrore, ekologjike të zonës përreth.

Ndikimi gjatë fazës operacionale të vënies në funksion të projektit pritet të jetë i vogël nëse merren masat e duhura. Ndikimet mund të vijnë si pasojë e:

- Derdhjeve aksidentale të hidrokarbureve gjatë lëvizjes së makinave.

Ndikimet e mundshme në burimet ujore mund të shfaqen për shkak të incidenteve që lidhen me shkarkimet aksidentale të karburantit, naftës dhe kimikateve të rrezikshme, ruajtjen dhe trajtimin e gabuar të mbetjeve.

Shiu dhe ujërat e zeza do të mblidhen përmes një rrjeti kulluesish. Kontraktori duhet të sigurojë që mos të ketë asnjë derdhje naftë nga automjetet dhe makineritë e tyre. Në rast të derdhjeve aksidentale, kontraktori duhet të marrë të gjitha masat emergjente për të pastruar siç duhet vendndodhjen e rastit aksidental dhe mbetjet duhet të depozitohen dhe transportohen siç duhet në vendet e caktuara. Në çdo rast, duhet të merren masa specifike në mënyrë që të sigurohen ndotjet e papritura gjatë operimit-funksionimit. Këto masa paraqiten në kapitullin tjetër të studimit.

Gjatë fazës operacionale, ndikimet parashikohet të jenë më pak të dukshme. Zona e projektit nuk do të ndryshohet si destinacion përdorimi. Për më tepër, ruajtja dhe trajtimi i mbetjeve, të cilat janë të parrezikshme, brenda terrenit mund të paraqesin rreziqe për ndotje të mundshme të tokës, veçanërisht në rastet e praktikave jo të duhura të menaxhimit të mbetjeve.

Impianti për deponimin e materialeve zjarrruduese të përdorura nuk ka ndotje të ujërave. ***Procesi i riciklimit nuk parashikon procesin e larjes dhe përdorimin e ujit në linjën teknologjike.*** Uji mund të përdoret vetëm në nyejt sanitare të objektit, i cili do të merret nga ujësjellësi përkates dhe do të shkarkohet në gropën septike.

8.2.3. Ndotja e tokës

Toka (dheu) si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vije deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të saja.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të zonës duhet të merren këto masa:

- Materiali do të grumbullohen, do të vendoset në deponinë e posaçme për trajtim;
- Materiali bartet me ekskavator i cili nuk do të ketë rrjedhje të vajrave;
- Materiali pas deponimit do të vendoset në thasë si material final, thasët me peshe 1500Kg-1800Kg përmes pirunorve barten deri në deponi të thasëve e cila nuk ka rrjedhje të materialit dhe nuk ka dëmtim të tokës.
- Duhet të behet mbjellja e sipërfaqeve të pa shtruar me zhavorr me barë dhe drunj dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra dhe për çështje vizuale.

Gjatë procesit të deponimit të materialeve nuk do të ketë kontaminime direkt të tokës, përveç rrjedhjeve eventuale të ndonjë automjeti.

8.2.4. Zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrimin e njeriut në punë etj.

Lokacioni i objektit nuk është i ekspozuar zhurmës. Në kuadër të aktiviteteve në objekt nuk shkaktohet ndonjë zhurmë që do binte ndesh me ligjet në fuqi për ndotje nga zhurma, për faktin që zhurma bëhet vetëm nga lëvizja e kamionëve për bartjen e materialit.

Gjatë ditës nga ora 07:00 - 19:00 niveli i zhurmës nuk do të kalojë mbi 64 dBA ashtu siç parashihet me Udhëzim Administrativ.

Sipas gjendjes faktike mund të konstatojmë se niveli i zhurmës i shprehur është nën vlerën e lejuar dhe nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në ngritjen e nivelit të zhurmës për mjedisin. Në pajtim me ligjin orari zgjat 12 ore dhe fillon nga ora 07:00 deri në 19:00.

Zhurma nga aktiviteti i ndërtimit mund të jetë serioze për një periudhë të shkurtër kohore. Nivelet e zhurmës të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, në varësi të fazës përgatitore dhe detyrave specifike që kryhen. Zhurma e krijuar gjatë fazës së operimit shkaktohet kryesisht nga sa vijon:

- Përdorimi i makinerive/automjeteve për nevoja operative;
- Lëvizja e automjeteve të rënda dhe
- Trafiku, për shkak të transportit të personelit.

Makineritë dhe automjetet e përdorura në punët përgatitore konsiderohen si burimi më kryesor i zhurmës. Ndikimi nga zhurma shtesë e krijuar për shkak të lëvizjes së automjeteve të rënda në rrjetin rrugor të zonës është në të shumtën e rasteve mesatare deri në e papërfillshme. Zhurma e krijuar nga automjetet e punëtorëve është pothuajse gjithmonë e pakonsiderueshme.

Zhurma gjatë operimit mund të ndikojë kryesisht në zonat e ndjeshme të ekosistemit të cilat janë afër impiantit dhe vendbanimeve të ndodhura afër vendit të projektit dhe përgjatë rrugëve.

Gjatë fazës operationale të projektit nën studim, niveli i zhurmës do të rritet nga ai aktual nga zhurma e krijuar nga makineritë, invertorët dhe transformatorët.

Pajisjet që lëshojnë zhurmë duhet të jenë në përputhje me standardet e zbatueshme të zhurmës së BE-së për këto pajisje siç përshkruhet në Direktivën e BE-së nr. 2000/14/KE të

Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 8 majit 2000, për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare, në lidhje me emetimin e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim të jashtëm. Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në zonë, ndërkohë që në zonat e ndjeshme, mund të aplikohen masa mbrojtëse ndaj zhurmave.

8.2.5. Ndikimet në florë dhe faune

Në bazë të studimeve të bëra në lokacionin e cekur më lartë e që kanë të bëjnë me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës kanë treguar së mund të vije deri te ndikimet në biodiversitet (flore dhe fauna) në qoftë se shkelen rregullat të cilat janë të parashikuara me ligje për mbrojtjen e mjedisit. Mirëpo në bazë të vlerësimit të gjendjes faktike në terren respektivisht në lokacionin e caktuar ku do të operoj impianti, mund të kolaudojmë se nuk kemi konstatuar dëmtim të florës as të vegjetacionit. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative në faunë.

8.2.6. Ndikimet në ekologjinë lokale

E gjithë zona e Mitrovicës është ndikuar nga ndërhyrje të ndryshme dhe aktiviteti njerëzor. Vërehet gjithashtu dhe prania e specieve ekologjike të ndjeshme në një distancë të përcaktuar nga vendi i propozuar.

Ndikimet kryesore në ekologjinë lokale përfshijnë:

- Ndikimet nga aktivitetet e operimit tek habitatet dhe speciet, në mënyrë specifike ndikimet tek speciet që ndërtojnë strofulla, dhe efekti i depozitimit të sedimenteve dhe ndotësve në trupat ujorë përreth;
- Instalimi i rrugëve hyrëse dhe të brendshme për projektin dhe instalimi i linjave dhe kullave të transmetimit;
- Ndikimet tek shpendët, duke u përplasur potencialisht me makineritë.

Heqja e bimësisë nuk do të jetë evidente, për shkak se objekti industrial është në shfrytëzim dekada më parë, e në këtë rast nuk do të ndikojnë tek speciet e shkurreve dhe në humbjen e lidhjes midis habitateve ose burimeve brenda një habitati. Zhdukja e bimësisë nga vendi i projektit mund të sjellë humbjen e gjitarëve të vegjël, insekteve dhe zogjve.

Aktivitetet e operimit do të shkaktojnë gjenerimin e zhurmës që do të largojnë avifaunën nga habitatet e afërta të plantacionit shtëpiak dhe trupave ujorë. Ngarkesa e

sedimentit mund të rritet në kanalet ekzistuese të zonës së projektit për shkak të menaxhimit jo të duhur të tokës, gjë që do të ndikojë në faunën ujore.

Shqetësime të tjera që duhet të vlerësohen më tej gjatë fazës së vënies në funksion janë ndikimet tek organizmat ujor.

8.2.7. Ndikimet në komunitetin dhe ekonominë lokale

Gjatë fazës së ndërtimit pritet që struktura sociale e komunitetit të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë afatshkurtër për shkak të ndërhyrjes së të ardhurve të rinj në zonë. Prania e punëtorëve gjatë fazës së operimit-funksionimit mund të ndikojë në jetën sociale të komunitetit lokal, duke marrë parasysh që punëtorët do të jenë vizitorë nga rajone të tjera. Përfshirja e fluksit të përkohshëm të punëtorëve të jashtëm shoqërohet me një rritje të cenueshmërisë dhe prekshmërisë së komuniteteve lokale ndaj patologjive të ndryshme sociale, siç janë rritja e krimit, alkoolizmi, rreziku i përhapjes së sëmundjeve të transmetueshme, rritja e volumit të trafikut dhe rreziku më i lartë i aksidenteve etj. Përveç kësaj, rreziqet e shtuara nga fluksi i punëtorëve në ndërtim dhe lëvizja e rënduar e trafikut do të sjellë shqetësime në jetesën e komuniteteve lokale dhe do të rrisë rreziqet për aksidente rrugore.

Një tjetër ndikim i konsiderueshëm në këtë fazë do të jetë ai i shkaktuar nga pajisjet dhe aktivitetet që do të zhvillohen. Pajisjet dhe aktivitetet do të krijojnë zhurmë dhe dridhje gjatë fazave të operimit-funksionimit, duke ndikuar rrjedhimisht në receptorët njerëzorë dhe duke shkaktuar shqetësime. Ky është një ndikim negativ dhe i tërthortë, edhe pse parashikohet të jetë një ndikim afatshkurtër. Shkalla e këtij ndikimi do të jetë e ulët pasi operimit-funksionimit nuk do të zbatohet në zona të banuara.

Faza e operimit-funksionimit pritet të ndikojë në ekonominë lokale si rezultat i krijimit të drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe të induktuar të vendeve të punës, rritjes së të ardhurave shtëpiake përmes pagave dhe shpenzimeve të projektit. Bazuar në aftësinë e vlerësuar të fuqisë punëtore në rajon, pjesa më e madhe e rekrutimeve lokale dhe rajonale do të jenë për pozicione gjysmë të kualifikuar dhe të pakualifikuar. Ky projekt është një burim i mundshëm për aktivitete të reja ekonomike dhe rekreative, veçanërisht për zonën turistike.

Për më tepër, mund të ketë edhe një rritje të përfitimeve për komunitetin dhe ekonominë lokale si rezultat i prokurimit lokal të materialeve për ndërtim dhe shërbimeve të tjera për furnizimin e projektit.

8.2.8. Ndikimet në trashëgiminë kulturore

Bazuar në provat ekzistuese të literaturës, toka e propozuar për Impiantin për Deponimin Materialeve Zjarrrduese të përdorura, në Shupkovc, duket se nuk ndërhyr në asnjë zonë arkeologjike. Ndërtimi i projektit të propozuar nuk përbën asnjë kërcënim për ndonjë material kulturor në këtë zonë.

8.2.9. Ndikimet nga trafiku

Gjatë punëve të operimit-funksionimit, do të ketë një numër të madh të stafit që do të punojnë për projektin dhe si pasojë, do të ketë shumë automjete, pajisje dhe makineri në terren. Lëvizja e trafikut në zonë do të rritet për shkak të afërsisë me rrugën kombëtare dhe disa automjeteve që lëvizin përreth zonës (përfshirë kamionë të rëndë që transportojnë materiale inerte dhe materiale të gërmuara). Në këtë aspekt, ndikimet kumulative gjatë fazës operacionale konsiderohen të mëdha/të moderuara, për shkak të aktivitetit afatgjatë në zonë.

8.3. Rreziku i shëndetit dhe sigurisë në punë

Hartimi i strukturës së propozuar të Impiantit për Materialeve Zjarrrduese të përdorura, do të përfshijë një sërë aktiviteteve që mund të jenë të pasigurta për punëtorët dhe komunitetin lokal, në rast se nuk merren masa lehtësuese. Shembuj të këtyre veprimtarive përfshijnë gërmimet për themelet e objekteve, përdorimin e shllamit të shpimit, punën në lartësi, hapjen e kanaleve, etj. Këto aktivitete kërkojnë përdorimin dhe vënien në funksion të pajisjeve lëvizëse të tokës, makinerive dhe automjeteve për shërbime të rënda.

9. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE

Masat e mbrojtjes së mjedisit që duhet të zbatohen gjatë fazës së operimit të **“Impiantin qe synon te ushtroj veprimtarin për; Grumbullit, klasifikimit, rikuperimit, thërrmimit-thyerjes, paketimit dhe magazinimit të mbetjeve te tullave zjarrrdurese (refraktare)”**, në fshatin Shupkovc (zona industriale e Trepçës), kanë për qëllim zvogëlimin e ndikimeve në mjedis për shkak të rritjes së qarkullimit, përdorimi i mekanizmave të rëndë ndërtimor, gërmimeve të dheut dhe aktivitete tjera gjatë ndërtimit dhe operimit. Gjatë fazës së përgatitore duhet të ndërmerren këto masa të mbrojtjes së mjedisit.

Fazat e përgjithshme të zhvillimit për projektin në shkallë të gjerë mund të kategorizohen si më poshtë:

- Mobilizimi / Para-ndërtimi: të tilla si përgatitja e vendit, mobilizimi i pajisjeve dhe materialeve në zonën e projektit;
- Instalimi: përfshirë punimet civile, punimet elektrike dhe instalimin e pajisjeve;
- Operacioni: Funksionimi i impiantit dhe mirëmbajtja rutinë;
- Demontimi: Çmontimi i pajisjeve dhe pajisjeve shoqëruese dhe rehabilitimi i zonës.

Hapësira totale e propozuar e impiantit është 54 ari dhe propozohet të funksionalizohet në një fazë të vetme.

Ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale kanë të bëjnë me aktivitetet e ndërmarra gjatë fazave përgatitore, operacioneve dhe çaktivizimit. Aktivitetet kryesore gjatë këtyre fazave janë përmbledhur në seksionet më poshtë.

- Mobilizimi/Parandërtimi
- Faza e ndërtimit dhe instalimit
- Operimi dhe mirëmbajtja
- Çmontimi dhe mbyllja

9.1.Masat e marra dhe mobilizimi / Para-ndërtimi

Faza e mobilizimit duhet të zhvillohet para se të fillojë puna përgatitore dhe instalimit në vendin e projektit. Faza përgatitore përfshin zhvillimin e fazave të projektimit të detajeve, mobilizimit dhe përgatitjes së zonës së Projektit. Projekti do të zbatohet nga “Kontraktori kryesore”. “Kontraktori kryesore” do të jetë përgjegjëse për zhvillimin e projektimit, ndërtimit

(rregullimin e objektit ekzistues dhe montimin e pajisjeve) dhe komisionimit të detajuar të impiantit.

Faza e mobilizimit përfshin porositjen e materialeve dhe pajisjeve, nënshkrimin e kontratave me nënkontraktorët dhe punësimin e stafit. Kjo fazë gjithashtu përfshin mobilizimin e punëtorëve, planifikimin dhe transportimin e përbërësve të projektit, pajisjeve dhe materialeve, si dhe përgatitjen e vendit që përfshin pastrimin, nivelimin, nivelimin e vendit dhe krijimin e vendit në zonë për ndërtimin e objekteve. Ky projekt nuk përfshin ndërtimin e godinave për strehimin e punëtorëve.

Pajisjet e rënda dhe pajisjet e tjera do të zhvendosen në vendin e projektit në fillim të aktiviteteve përgatitore për aktivitetet e punës civile dhe instalimin e pajisjeve. Të gjitha materialet, pajisjet elektrike dhe strukturore janë planifikuar të arrijnë në zonën e projektit përmes rrugës ekzistuese në "kontejnerë". Përveç pajisjeve, projekti do të kërkonte gjithashtu automjete dhe pajisje të mëdha ndërtimi, të tilla si buldozerë, ekskavatorë, vinça, kamionë, makinerit operative etj.

Gjatë periudhës së përgatitjes së Zonës së Projektit, fuqia punëtore e kërkuar për sigurinë e vendit, punët manuale, punët civile, transportin e mallrave dhe shërbime të tjera të ngjashme ka shumë të ngjarë të merren nga zona lokale.

9.2.Masat e marra gjatë fazës së përgatitore dhe instalimit

Faza përgatitore e projektit do të përfshijë shumë aktivitete dhe faza, të tilla si:

- Ndërtimi / përmirësimi i rrugëve të brendshme të hyrjes;
- Nivelimi i tokës;
- Rrethimi me gardh rreth zonës së Projektit;
- Rregullimi dhe instalimet elektrike;
- Instalimi i rezervuarit të ujit për stafin dhe aktivitetet e operatorëve;
- Instalimi i gropës septik;
- Testimi dhe komisionimi i pajisjeve dhe projektit në tërësi;
- Pastrimi i zonës së projektit.

Një pjesë e zonës së Projektit do të përdoret si zonë magazinimi ku do të vendosen pajisjet, pajisjet sanitare (portative) dhe kontejnerët.

9.3.Masat për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Për zbutjen dhe menaxhimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të identifikuar në seksionin paraardhës, kompania do të hartojë dhe zbatojë me përpikëri një Plan të Menaxhimit të Mjedisit dhe masave zbutëse i cili ka për qëllim parandalimin ose minimizimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit si dhe shëndetin e sigurinë në punë.

Plani i menaxhimit të mjedisit synon respektimin e standardeve mjedisore në përputhje me legjislacionin kosovar dhe praktikën më të mira ndërkombëtare gjatë kryerjes së aktivitetit përgatitëse të deponisë dhe më pas gjatë operimit të saj, në mënyrë të sigurtë dhe efektive, me qëllim final mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e ndotjeve dhe rritjen e përfitimeve në aspektin social.

Konkretisht, ai fokusohet në ndikimet e identifikuar në mjedis në fazat përgatitore dhe të shfrytëzimit të veprës, si dhe masat përkatëse parandaluese dhe/apo minimizuese deri në nivelet e lejuara ligjore.

9.3.1. Identifikimi dhe përcaktimi i masave zbutëse dhe menaxhuese

Masat kryesore të propozuara në Planin e Menaxhimit të Mjedisit duhet të adresojnë zgjidhjet më optimale për minimizimin e ndikimeve të identifikuar negative në mjedis.

Këto masa duhet të synojnë:

- Rehabilitimin e sipërfaqeve që do të përdoren dhe ndikohen nga veprimtaria përgatitore;
- Sistemimin e masës së mbetjeve inerte nga procesi përgatitor. Në bashkëpunim me autoritetet vendore të bashkisë do të përcaktohet vendi ku do të depozitohen këto mbetje.

Zbatimi me korrektësi i këtyre masave do të bëhet i mundur nga përdorimi i teknikave të mëposhtme:

- Piketimi i saktë i sipërfaqes ku do të operoj dhe kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda saj;
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet lagies së zonës së punës dhe mbulimit të makinerive gjatë transportit (gjatë fazës ndërtimore);
- Kontrolli i dherave të gjeneruara, depozitimi i tyre në zona të aprovuara dhe sistemimi i tyre nëpërmjet kompaktësimit;
- Kontrolli teknik i mjeteve të punës për të parandaluar rrjedhjet e karburantit;

- Menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara, urbane, të rrezikshme, etj., gjatë fazës përgatitore dhe funksionale.

9.3.2. Masat e mbrojtjes së ajërti

Masat që duhen të merren në parandalimin e mbrojtjes së ajërti janë si më poshtë:

- Përshtatja dhe përgatitja e infrastrukturës së ndërtimit ku përfshihen vendosja e procesit teknologjik dhe sistemimi i kantierit të objektit;
- Vendosja e sistemit të depluhimit në objektin ku do të vendoset linja e prodhimit;
- Vendosja e sistemit të ujitjes në linjën e thërrimit për uljen e grimcave në ajër;
- Të evitohen të gjitha shkarkimet e grimcave në ajër gjatë procesit të sortimit, duke i mbuluar shiritat e sortuesit mobil;
- Ndarja e linjës së thërrimit nga pjesa tjetër e procesit të punës (në aspektin fizik), pasi që i gjithë procesi teknologjik do të vendoset brenda objektit;
- Kontroll dhe mirëmbajtje në gjendje të mirë teknike të mjeteve të punës, si dhe përdorim i lëndëve djegëse cilësore për motorët (nëse ka mundësi të energjisë);
- Transporti i materialeve duhet të bëhet me kamionë me karrocë të mbuluar;
- Të punësuarit duhet të pajisen me maska dhe veshje adekuate gjatë procesit të thërrimit.

Mund të përfundojmë se nga impianti i materialeve zjarrruese të përdorura, ndikimi në ndotjen e ajrit do të jetë minimal, për arsye se në impiant do të merren të gjitha masat e parapara. ***Në rast të bluarjes-thërrimit të tullave në fjalë efekti i ndotjes në ajër do të jetë i pa përfillshim ngase kjo makineri e cila përdoret për thërrimin e tullave zjarrruese, operon në hapësirë të mbyllur dhe nuk ka aktivitetet të përditshëm, një herë (një ditë) në muaj apo dy herë me se shumti.*** Makineria është mobile me rrota dhe mund të lëvizë nga një vend në tjetrin shumë lehtë.

9.3.3. Masat për mbrojtjen tokës

Marrja e masave për mbrojtjen e tokës janë një numër i konsiderueshëm që duhet të merren në konsideratë, e të cilat më poshtë do të përmenden:

- Përshtatja dhe përgatitja e infrastrukturës ku do të funksionalizohet projekti, ku përfshihen hapja e rrugëve të aksesit, dhe sistemimi i kantierit të objektit;

Shqetësim i sipërfaqes së tokës (sidomos tokës bujqësore) konsiderohet të jetë i vogël. Ndotje është e mundshme me rastin e derdhjes së hidrokarbure dhe lubrifikant si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit. Masat që do të merren;

- Lëvizja dhe parkimi i makinerive brenda zonave të caktuara;
- Përcaktimi i vendeve më të përshtatshme për këtë qëllim;
- Planifikimi paraprak i punës dhe realizim i operacioneve në kohë sa më të shkurtër;
- Kontrolli dhe testimi periodik i gjendjes teknike të makinerive;
- Nëse detyrues duhet të bëhet ndërrimi i vajit në vend punishte për shkak të avarive në makinat e punës, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit;
- Në punishte duhet të ketë material (pluhur druri) që në raste të derdhjeve të vajrave të ndryshme të intervenohet menjëherë për pastrim.

Sigurisht se në çdo proces të punës ka gjenerim të mbetjeve inerte dhe të ngurta. Këto mbetje duhet të trajtohen:

- Një pjesë e mbetjeve inerte të gjeneruara do të përdoren gjatë fazës përgatitore të deponisë;
- Pjesa tjetër e mbetjeve të ngurta do të depozitohen në vendet që do të përcaktohen në bashkëpunim me organet;

9.3.4. Masat e mbrojtjes së ujit

Sa i përket ujrave në aspektin e shkarkimit nga procesi teknologjik. Nuk pritet ndikime në cilësinë e ujrave pasi që nuk ka përdorim të ujit në proces teknologjik.

Duke e parë që veprimtaria ose impianti në fjalë do të vendoset në një **objekte ekzistues industrial**, i cili i ka të rregulluar infrastrukturën e ujrave fekale dhe atyre industriale.

Ne rastin tone, siç e kemi përmendur më sipër do të kemi vetëm ujera fekale, ku këto ujera fekale janë të lidhura me kanalizimin e kombinatit Trepça.

9.3.5. Masat e marruara në Florë

Nuk parashikohet të pastrohet një sipërfaqe e vegjetacionit në zonën e projektit. Për të mbajtur ndikimin në kufijtë e projektuar, përpara fillimit të gërmimit dhe ndërtimit të rrugës hyrëse, duhet të kryhet punë rivlerësuese dhe të piketohet saktë gjurma e projektit.

Duhet bërë përdorimi maksimal i rrugëve ekzistuese, si dhe sistemimi i dherave për përdorim në rehabilitimet biologjike pas përfundimit të punimeve.

9.3.6. Masat e marruara në Faunë

Shqetësim i habitatit natyror që përdoret kryesisht nga zvarranikët, amfibët dhe shpendët.

Inspektimi para fillimit të operacioneve për të analizuar me kujdes sjelljet e botës së gjallë dhe për të përcaktuar momentet e ndërprerjes së aktivitetit në faza të caktuara të ciklit vjetor të zhvillimit të biodiversitetit, si p.sh. koha e riprodhimit. Mbyllja e rrugëve të përkohshme të kantierit në përfundim të fazës përgatitore për të shmangur hyrjen e panevojshme të banorëve në zona të ndjeshme ekologjike.

Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e punimeve dhe qarkullimit të makinerive.

Gjatë operacioneve të transportit dhe operimit të deponisë mund të ndodhin aksidente të tilla si shtypja dhe vrasja e zvarranikëve dhe amfibëve në zonë.

Për këtë do të instruktohen punëtorët dhe kontraktorët të tregojnë kujdesin e duhur dhe lëvizja e mjeteve të bëhet me shpejtësi të ulët me qëllim që terreni të shihet qartë dhe të krijohet mundësia e shmangies së përplasjes së faunës. Vendosja e tabelave sinjalizuese do të konsiderohet nëse gjatë inspektimit në terren rezultojnë kalime të shpeshta të zvarranikëve apo amfibëve përgjatë zonës së projektit (përgjatë rrugëve etj).

Masa më e përshtatshme për të adresuar këtë ndikim vlerësohet minimizimi i kohës së operacioneve në terren dhe largimi sa më i shpejtë i mjeteve të rënda që gjenerojnë zhurmë dhe shqetësim për faunën. Ideale do të ishte sikur në stinën e pranverës (muajt mars-qershor) të kufizoheshin operacionet më shqetësuese për faunën për t'i dhënë mundësinë e riprodhimit në zonën e projektit.

9.3.7. Mbrojtja nga zjarri

Kontraktuesi do të siguroj dhe mirëmban aparate adekuate për fikje të zjarrit në punishte dhe hapësirat me rrezik nga zjarri do të rrethohen dhe shënohen si dhe do ta furnizoj impianti me aparate speciale për fikjen e zjarrit, sipas nevojës. Agregatet dhe akumulatorët e tyre dhe pompat e ujit duhet në mënyre adekuate të mbrohen ndaj vandalizmit dhe vjedhjes. Veç nëse udhëzohet ndryshe nga mbikëqyrësi, kontraktuesi me punën e tij nuk do të pengoj

(bllokoj) rrugët ose qasjen në objektet tjera, nuk do të rrënon (largon) asnjë rrethojë dhe nuk do të bllokoj rrjedhjet e ujit dhe kanalizimeve, por nëse vie deri te bllokimi ai duhet menjëherë të largoj bllokimin dhe sanon dëmtimet.

10. MUNDËSIA E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR

Plani i rehabilitimit ka për qëllim të rehabilitoj zonat të cilat janë ndikuar nga veprimtaria e impiantit. Nisur nga karakteri i punimeve përgatitore vlerësohet se punimet e rehabilitimit do të jenë punime lehtësisht të zbatueshme. Këto punime do ti klasifikojmë në dy tipe të rëndësishme, si:

- Punime inxhinierike;
- Punime biologjike.

10.1. Punimet Inxhinierike

Punime inxhinierike bëhen me qëllim rehabilitimin e terrenit të ndikuar nga punimet përgatitore dhe qarkullimi i automjeteve të rënda. Këto punime do të zbatohen paralelisht me zbatimin e punimeve përgatitore duke u finalizuar me rehabilitimin përfundimtar pasi të kenë përfunduar punimet ndërtimore dhe para vendosjen në funksionim të impiantit. Këto punime do të konsistojnë kryesisht në këto zëra:

- Nëse do të jetë e nevojshme subjekti do të ndërhyjë në rrugën kryesore duke mundësuar mbushjen dhe sistemimin e saj, hapjen e kanaleve të kullimit me qëllim që infrastruktura ekzistuese të mos ndikohet nga ky projekt;
- Zona e kantierit të objektit është e pozicionuar larg zonës së banuar, e cila në përfundim të punimeve do të kthehet në gjendjen fillestare.

10.2. Punimet biologjike

Punimet biologjike do ti referohen punimeve të cilat kanë për qëllim riaftësimin e zonave të ndikuara, karakteristike të zonës. Procesi i rehabilitimit do të fillojë në përfundim të punimeve përgatitore dhe do të vazhdojë gjatë fazës së testimit dhe funksionimit të impiantit. Periudha e nevojshme për arritjen e plotë të rehabilitimit dhe rikthimin e mjedisit në gjendjen fillestare parashikohet 1-3 vite. Plani i Rehabilitimit për projektin do të përfshijë:

- Përdorimin e dheut sipërfaqësor për veshjen sipërfaqësore të tokave të ndikuara të zonës së punës dhe zonave përreth;
- Pastrimi i të gjithë sipërfaqeve të shfrytëzuara përkohësisht nga projekti dhe mbetjet e ndryshme (si dhera natyralë të depozituar përkohësisht), rehabilitimin, si dhe rikthimin e tyre në gjendjen e mëparshme;
- Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella.

Preventivi i punimeve të rehabilitimit dhe kostot do të paraqiten të detajuara në studimin e plotë të VNMS-së.

11. MENAXHIMI DHE MONITORIMI I MJEDISIT

11.1. Kontraktori

Kontraktori do të jetë përgjegjës për zbatimin e planit shoqëror dhe mjedisor të monitorimit dhe menaxhimit gjatë gjithë periudhës përgatitore. Detyrat kryesore të kontraktorit do të përfshijnë:

- Zbatimi i menaxhimit të mjedisit, sigurisë dhe shëndetësisë gjatë punimeve përgatitore;
- Rregullimi i burimeve njerëzore dhe financiare, kujdesi shëndetësor dhe siguria;
- Raportet dhe komunikimi për performancën mjedisore gjatë punimeve përgatitore;
- Përgjegjësia për zbatimin e masave të përfshira në planin e monitorimit, si dhe menaxhimin social dhe mjedisor;
- Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi do të themelojë një njësi mjedisi, e përbërë nga të paktën një zyrtar mjedisi, i cili do të jetë përgjegjës për aspektet sociale dhe mjedisore.

Përgjegjësitë e zyrtarit mjedisor - plani i monitorimit dhe menaxhimit të mjedisit:

- Harton planin mjedisor dhe përcakton procedurat e punës të procedurave ekzistuese për përfshirjen e parametrave mjedisorë të nevojshme për zbatimin / modifikimin e tij;
- Organizon dhe zhvillon trajnime paraprake dhe periodike për çështjet mjedisore për të gjithë personelin;
- Ndihmon drejtuesit e Kontraktorëve për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm në lidhje me çështjet mjedisore;
- Mbikëqyrja dhe zbatimi ditor i VNM;
- Kontaktet me autoritetet lokale në lidhje me lëshimin e lejeve të nevojshme mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë;
- Ndihmon autoritetet në inspektimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë;
- Përgatit raporte vjetore për procesin e implementimit për inxhinierin.

11.2. Inxhinieri i Mjedisit

Roli i inxhinierit do të jetë të mbikëqyrë me efikasitet zbatimin gjatë fazës përgatitore dhe masat zbutëse, të propozuara nga kontraktori.

Inxhinieri do të kryejë përgjegjësitë e tij mjedisore përmes:

- Ndihmën që ai do të sigurojë për kontraktorin në përgatitjen e planit të menaxhimit dhe monitorimit të mjedisit në përputhje me fushën e tij të punës;

- Organizimi i seancave udhëzuese për zyrtarin e mjedisit të kontraktorit;
- Të sigurohet që plani i lartpërmendur të përgatitet para fillimit të punëve dhe që përgjegjësitë të përcaktohen qartë;
- Të inspektojë çdo ditë zbatimin e masave mjedisore në të gjithë zonën e ndërtimit për nevojat e kontraktorit;
- Të sigurohen që të gjitha lejet mjedisore, të kërkuara nga legjislacioni kombëtar, janë marrë dhe janë të vlefshme;
- Të ndihmojë organizimin e auditiveve të jashtme mjedisore.

11.3. Qeveria e Kosovës / Ministria përkatëse / Klienti

Qeveria / ministria përkatëse është organi kryesor vendimmarrës për procesin e zhvillimit dhe zbatimit të projektit. Ai miraton projektin dhe masat e propozuara të zbutjes dhe kompensimit pas konsultimeve me autoritetet përgjegjëse të mjedisit.

Ai gjithashtu sigurohet që dispozitat e zbatimit të VNM (lista e masave që duhet të zbatohen, programi i monitorimit, etj.), janë përfshirë në paketën kontraktuale të inxhinierit dhe kontraktorit. Së fundmi, qeveria / klienti luan rolin kryesor në zbatimin e masave të kompensimit në lidhje me shpronësimin, ri-strehimin dhe kompensimin financiar për humbjen e pronës private (nëse do të ketë tokë private). Qeveria / Klienti do të marrë përsipër përgjegjësinë nga kontraktori për zbatimin e masave mjedisore në fund të fazës së ndërtimit.

11.4. Autoritetet përkatëse të mjedisit

Autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare të Kosovës, përgjegjëse për inspektimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit, do të kenë një rol të dyfishtë:

- Të garantojë që veprimtaritë e ndërtimit janë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret kombëtare, si dhe lejet dhe autorizimet përkatëse (p.sh. lejet për ujë, gjërmim, dhe nxjerrjen e materialeve, emetimet në ajër, lejen për hedhjen e mbeturinave, (përfshirë transportin dhe magazinimi i mbetjeve të rrezikshme, etj.);
- Të kryejë një inspektim të rregullt për t'u siguruar që aktivitetet e ndërtimit po kryhen pas autorizimeve të lëshuara.

11.5. Monitorimi i mjedisit

Programi i monitorimit do të zvogëlojë kërcënimin për mjedisin, i cili mund të vie si rezultat i përgatitjes dhe përdorimit të rrugës.

Roli i monitorimit të mjedisit përcaktohet si më poshtë:

- Monitorimi i performancës mjedisore të procesit përgatitore;
- Kontrollimi i efikasitetit të masave të propozuara zbutëse;
- Kontrolli i niveleve të detyrave të menaxhimit mjedisor të marra nga kontraktori;
- Identifikimi i përmirësimeve të VNM dhe aktivitetet korigjuese.

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për monitorimin e procesit gjatë periudhës së ndërtimit. Gjatë përdorimit të impiantit, parametrat mjedisorë do të monitorohen nga autoritetet lokale, si dhe ekspertë të pavarur.

Plani i monitorimit të impiantit do të përfshijë parametrat e mëposhtëm:

- Nivelet e zhurmës në banesa dhe zona të tjera të ndjeshme së bashku me impiantin;
- Nivelet e ndotjes së ajrit në një zonë rezidenciale në afërsi të impiantit;
- Niveli i gjelbërimit të mbjellë dhe niveli i riprodhimit të bimësisë së pastër;
- Cilësia e ujit në linjat ujore lokale;
- Sëmundjet, të shkaktuara nga emetimi i pluhurit siç raportohen nga qendrat e kujdesit shëndetësor;
- Numri i aksidenteve të trafikut të raportuara;
- Mbikëqyrja e sistemit të kullimit pas ndërtimit;

Monitorimi mbulon çështje mjedisore si:

- Ujërat sipërfaqësorë;
- Ujërat nëntokësorë;
- Cilësia e ajrit (pluhuri);
- Cilësia e ajrit (NOx);
- Zhurma;
- Fauna, flora dhe habitatet natyrore;

Metodologjia, parametrat, frekuencat dhe procesi i raportimit janë në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi në Republikën e Kosovës.

12. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Problematika e shfrytëzimit të tokës bujqësore për nevoja jobujqësore është rregullua me Ligj dhe akte nënligjore. Sipas Ligjit për tokën Bujqësore (Ligji nr. 02/L-26) për Rikultivim të tokës bujqësore, me rastin e ndërrimit të destinimit të tokës për nevoja të eksploatimit të mineraleve. Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore konsiderohen objektet e karakterit të përkohshëm, si shfrytëzimi për vendosjen e impiantit, depozitë e mbeturinave, hirit industrial dhe mbeturinat e industrisë së drurit. Toka bujqësore pas një periudhe të caktuar përsëri mund të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore.

Rikultivimi i tokës bujqësore: toka bujqësore e cila është shfrytëzuar për destinime tjera, e cila nuk ka karakter të përhershëm, i kthehet destinimit të parë apo destinimit tjetër, përkatësisht aftësohet për prodhimtari bujqësore sipas projektit për rikultivim. Pëlqimin në projektin për rikultivim e jep organi kompetent komunal për bujqësi. **Toka në lokacionin e impiantit është hapësirë industriale e cila nuk pritet të ridestinohet.**

12.1. Objektivat e rikultivimit

Pas përfundimit të aktivitetit (kjo varet nga kërkesa e tregut dhe gjendja teknike e pajimeve), pas këtij afati pajimet duhet të çmontohen e të vendosen në një lokalitet tjetër apo në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

- Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem;
- Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin e bazës së impiantit me reparacion të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues.

Qëllimi i Rikultivimit- Qëllimi kryesor i rregullimit të hapësirës pas pushimit të aktivitetit është kthimi i kësaj zonë të degraduar në një zonë me një peizazh shumë rekreativ për komunitetin për rreth.

Në përgjithësi, zona do të paraqesë element me vlerë të lartë për mjedisin, në të cilin do të ekzistojnë në të njëjtën kohë shfrytëzimi bujqësor dhe vendbanimi për botën bimore dhe shtazore.

Krijimi i tokave antropogjene në këtë zonë nënkupton ripërtëritjen e tokës së dëmtuar, harmonizimin e peizazhit, si dhe zgjerimin e kapacitetit të filtrit natyrorë të ajrit. Për rikultivim do të jetë e nevojshme shtresa pjellore e tokës dhe shtresa potenciale pjellore me përmbajtje agrokimike dhe mekanike. Sipas rregullave krijimi i biomasës me anë të rikultivimit në toka të degraduara ka për qëllim gjelbërimin dhe përmirësimin e kushteve të mjedisit të jashtëm konformë peizazhit rrethues.

13. PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e *“Impianti për Deponimin e Materialeve Zjarrduruese të përdorura dhe bluarja e tyre”*, si dhe në bazë të vlerësimit të projektit të propozuar, për lokacionin e analizuar sipas autorit të raportit nuk rrezikon mjedisin sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë duhet të parashihet që në rast se vije deri te ndotja duhet të ndermirren masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri të rrezikimi i mjedisit jetësor.

Nga sa u tha më sipër nxjerrim si përfundim se:

- Objekti i cili do të shfrytëzohet ndodhet në një zonë të përshtatshme për këtë lloj aktiviteti, i cili do të ndikojë pozitivisht edhe në zhvillimin ekonomik të zonës;
- Teknologjia që do të shfrytëzohet është e përshtatshme dhe funksionale;
- Në veçanti, nga analiza e kryer në tërësi veprimtaria e këtij aktiviteti, nuk konstatohen ndikime të veçanta mjedisore si në florë, faunë, tokë, ujë dhe ajër.

Me qëllim të zvogëlimit të mëtejshëm të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave shtesë të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në objektin për rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta. Nga vlerësimi në përgjithësi i këtij aktiviteti konstatohet se:

- Nuk vërehen ndikime negative të aktivitetit;
- Është lehtësisht i zbatueshëm;
- Teknologjia e shfrytëzuar është bashkëkohore;
- Makineritë dhe pajisjet janë të thjeshta,
- Zona ku zhvillohet ky aktivitet është zonë industriale.

Gjate funksionimit të këtij aktiviteti janë marrë të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedisin përreth. Për këtë qëllim ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor pasi:

- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta;
- Nuk ka shkarkime në ajër të gazrave apo tymrave jashtë normave të lejuara;
- Zhurmat në mjediset e punës pritet të jenë brenda normës sanitare të lejuar dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth;
- Ka vlera normale të temperaturës dhe lagështisë në mjediset e punës;
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë dhe masat për evitimin e rrezikut të zjarrit.

Si përfundim mund të konstatojmë se aktiviteti konsiderohet i përshtatshëm dhe i pranueshëm në zonën e zgjedhur nga investitori.

Pas punimit të këtij raporti, mund të vihet në përfundim se funksionimi i *“Impiantit për deponimin e materialeve zjarrduruese të përdorura dhe bluarja e tyre”*, në fshatit Shupkovc të Mitrovicës, nuk paraqet rrezik të ndikimit negativ në mjedis. Ndikimet në mjedis pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, si dhe nëse merren për bazë detyrimet nga ligjet dhe aktet nënligjore për mjedis, ndikimet negative mund të minimizohen në nivel të lakmueshëm dhe atë nën vlerat kufitare të përcaktuara me ligje dhe akte nën ligjore.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë institucionit kompetent dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës.

REFERENCAT

1. Illyrian Consulting Engineers sh.p.k. Tiranë, 2021;
2. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007, Prishtinë;
3. MMPH-AKMM –IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007, Prishtinë;
4. MMPHI (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I), Prishtinë;
5. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009, Prishtinë;
6. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016;
7. MMPH_IHMK – Resurset Ujore të Kosovës 2015;
8. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometeorologjik 2014;
9. Qavolli. R. (1997): Gjeografia regjionale e Kosovës. Prishtinë;
10. Të dhënat nga investitori.

Shtojca

- Certifikata e biznesit;
- Kopja e planit;
- Certifikata e pronësisë;
- Kontrata e marrjes me qera të tokës;
- Pëlqimi Komunal;
- Matjet gjeodezike;
- Cd-raporti i VNM-së.